Injektim silikati per papershkueshmeri ne lartesi te lageshtise.

-Per te siguruar papershkueshmerine ne lartesi te lageshtise. duke perfshire hapjen e vrimave , pastrimin dhe te gjitha operacionet e nevojshme.

-Injektim me presion te silikatit te lengshem duke hapur vrimat me diameter 12mm ne distance 10cm, ne nje kend rreth 30-45 °. Thellesia e shpimit sa $\frac{3}{4}$ e gjeresise se murit. Hapja e vrimave dhe injektimi do te behet ne dy radhe po te cilat jane te spostuara nga njera tjetra ne distancen 10-cm.

-Per hapje te perdoret nje trapan elektromagnetik me dridhje minimale. muret me boshlleqe te medha dhe muret me tulla te lehtesuara duhet tembushen fillimish me llaçe te rrjedhshem dhe pas kesaj te behet injektimi me presion me silikate te lengshem.

-Perfshihetn cdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund injektimit te silikatit ne menyre te sakte.

-Garanci per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

Davancale dritareje mermeri

-Per vendosjen e davancaleve mermeri realizohet:

-Fillim duhet qe siperfaqja qe do te vishet te pastrohen mire nga papastertite, mbeturinat etj si dhe te rrafshohet vendi.

-Siperfaqja lyhet me qumesht çimentojeose, qe lehteson ngjitjen e pllakave te mermerit.

-Ngjitja e pllakave te mermerit behet ose duke perdorur llaç ose ne rast se siperfaqja ku vendoset bazamaku eshte e rrafshet, atehere mundet qe davancali te ngjitet edhe me kolle. Ngjitja e davancaleve te mermerit nuk ndryshon nga ngjitja e bazamakeve te shkalleve.

Patinim tavani allçi (stuko)

-Me pare stukohen te gjitha hapësirat ne zonat e kontaktit te gipsim me muret ose ne vete pllakat e gipsit

-Patinohet e gjithë siperfaqja e tavaneve me stuko patinimi.

-Garanci per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

Lyerje e brendshme me hidromat

-Siperfaqja qe do te lyhet duhet te jete e trajtuar me fino suvatimi.

-Stukohet siperfaqja aty ku eshte e nevojshme dhe lemohet me leter xumparo per leminin e siperfaqes dhe largimin e kokrizave me diameter te madh suvase.

-Vendoset nje dore e vetme praimer (astar luerje) te pershtatshem, te aplikuar me furce mbi mure dhe tavane.

-Bojatise me dy duar te mureve dhe tavaneve me hidromat, te bardhe ose me ngjyre, deri ne mbarimin e punes ne menyre te sakte.

-Perfshihen punimet dhe mjeshterite e nevojshme per mbarimin e plote te punes ne menyre te sakte.

-Kampionet duhet t'i paraqiten me perpara Supervizorit te Kantjerit.

-Garanci per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

Lyerje e jashme fasada

-Siperfaqja qe do te lyhet duhet te jete e trajtuar me suvatim grafiato.

-Stukohet siperfaqja aty ku eshte e nevojshme dhe lemohet me leter xumparo per leminin e siperfaqes dhe largimin e kokrizave me diameter te madh suvase ne zonat ku suvatimi nuk eshte grafiato (kryesisht tavanet).

-Vendoset nje dore e vetme praimer (astar luerje) te pershtatshem, te aplikuar me furce mbi mure dhe tavane.

-Bojatise me dy duar te mureve dhe tavaneve me hidromat, te bardhe ose me ngjyre, deri ne mbarimin e punes ne menyre te sakte.

-Perfshihen punimet dhe mjeshterite e nevojshme per mbarimin e plote te punes ne menyre te sakte.

-Kampionet duhet t'i paraqiten me perpara Supervizorit te Kantjerit.

-Garanci per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

PUNIME DYER DRITARE

Dritare d/alumini dyfish xham.

-Furnizim dhe vendosje e dritareve sic pershkruhet ne V.T., permasat e se ciles duhet te percaktohen nga Kontraktori, bere me profile alumini me trashesi minimale 4,5 cm, dhe te lyer me pare ne menyre te rregullt, me ngjyre sipas P.P.

-Nje kontrolajloje e plote prej tubi metalik te xinguar lehte, do te fiksohet ne mur me fasheta hekuri me llac cemento (jo me tapa me filete). Skeleti i fiksuar i dritares do te vidhohet me telajon pas perfundimit te punimeve te suvatimit dhe bojatisjes. Kanata te hapshme me xhama do te vendosen me mentesha ne skeletin e dritares dhe do te pajisen me brava mbyllese ne tre drejtime dhe doreza.

-Xhamat te cilet do te jene dopio (me trashesi min. 4 mm transparent) do te fiksohen ne skeletin e duraluminit me ane te listelave te aluminit ne profilet metalike te dritares dhe te shoqeruara me gomina.

-Duke perfshire punimet e rifinitures ne murature si dhe cdo paisje tjeter per mbarimin e punes ne menyre te sakte.

-Cdo parti dritaresh duralumini me sasi mbi 100 m² do te shoqerohet me :

-Fleten e Garancise se prodhimit, me te dhenat e prodhimit te dritareve, aksesoreve dhe rrjetave te telit, mostrave e te prodhimit, llogaritjet strukture per perkuljen dhe raporte per proven e depertimit te ajrit, te ujit dhe te dhenat per montimin dhe mirembajtjen.

-Garancine per cilesise e duraluminit, nga uzinat prodhuese, shoqeruar me skicat do te tregojne prerjet vertikale te dritareve, permasat e plota te seksioneve, trashesine dhe dendesine e metalit, paisjet mberthyese, metoden e propozuar per vendosjen e aksesoreve, permasen dhe hapjen e dorezave, detajet e konstruksionit, menyren e vendosjes se xhamave, detajet e funksionimit te paisjeve metalike, detajet e kanatave, metodat dhe materialet per fashaturat, metoda e vendosjes se rrjetave te telit, metoda dhe materiali per vendosjen e pjeseve te brendeshme, kapakeve, parvazeve, trareve, dorezave, detajet e montimit si dhe pjese te tjera te lidhura me to.

-Dritaret e gatshme duhet te vine ne sheshin e ndertimit ne gjendje te pademtuar. Te garantohet ngarkim-shkarkimit dhe ngjitje-zbritjes gjate transportit per ne sheshin e ndertimit. Magazinimi duhet te garantoje mos demtinin gjate ngarkim -shkarkimit dhe vendosjes ne sheshin e pritjes, te jene te garantuara nga agresioni atmosferik, te perjashtohet shtremberimi dhe perkulja. Dritaret e demtuara duhet te riparohen dhe behen si te reja ose ne rast te kundert ato nuk duhet te perdoren por duhet te porositen dritare te reja. Te garantohen nga demtimi siperfaqja e luciduar gjate transportit magazinimit dhe montimit.

Dere d/alumini pa xham, me mbushje d/a.

-Furnizim dhe vendosje ne veper dyer te brendshme, permasat e percaktuara ne projekt, te perbera nga:

-Nje kontratelajo me tuba metalik xingato, qe do te fiksohet mire ne mure me fasheta te pershtatshme hekuri (cdo 1 m) dhe me llac cemento.

-Nje telajo alumini, qe do te vidhohet ne kontratelajo pas punimeve te suvatimit dhe bojatisjes. Sipas vizatimit te deres ne V.T., telajoja do te pajiset me mentesha dhe bllokuese per instalimin e kanateve te deres.

-Kanat dere me profile standarte alumini.

-Brava e zakonshme, doreza tunxhi ose plastike, dhe piastrat e gojezat perkatese dhe shum nga mbrapa.

-Buke perfshire punimet e rifinitures ne murature si dhe cdo paisje tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

-Kampione te artikujve te propozuar do t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per aprovim paraprak. Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

F.V dyer metalike me llamarine te zeze 27.75 kg/m²

-Furnizim dhe vendosje e dyerve te jashtme metalike, permasat e se ciles duhet te percaktohen nga nderrmarja ne kantjer, te perbera nga: nje kontratelajo e fiksuar ne profile metalike te pajisur me fasheta hekuri dhe nje dere nje ose dykanatshe me skelet kryesor me profile standarte metalike dhe panele llamarine me forma dhe dimensionet sipas vizatimeve ne projekt. Per porten perfshihet brava e sigurise ne tre drejtime mbylljeje dhe celesa ne tre kopje, piastrat dhe gojezat perkatese, doreza tunxhi dhe te gjitha pjeset e tjera speciale per mbylljen e portes si dhe aksesore te tjere, skelat e sherbimit, punimet e muratures si dhe cdo gje tjeter per ta konsideruar porten te perfunduar dhe funksionuese ne menyre perfekte.

-Kampione te artikujve te propozuar do t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per aprovim paraprak.

-Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Dyert e jashtme metalike te blinduara

Do te instalohen ne perputhje me kerkesat e standartit shteteror per montimin e tyre si me poshte:

-Nje kase metalike fiksohet ne mur me ane te ganxhave te celikut ose me ane te betonimit ne mur perpara suvatimit. Kasa metalike duhet te lyhet me boje metalike kundra korrozionit para se te montohet ne objekt. Madhesia e saj eshte ne varesi te trashesise se murit ku do te vendoset. Trashesia e fleteve te celikut te kases duhet te jete minimalisht 1,5 mm. Gjeresia e pjeseve anesore te kases duhet te jete minimalisht 10 cm kurse gjeresia e pjeses qendrore eshte ne varesi te gjeresise se murit dhe llojit te deres. Fletet e celikut te kases duhet te kthehen ose te saldohen sipas Kushteve Teknike te Zbatimit

-Kanati i deres se blinduar fiksohet tek kasa pas suvatimit dhe lyerjes. Kanati do te sigurohet me mentesha dhe ankerat e celesit gjate instalimit te pjeseve hapese te deres. Ne kete kanat do te vendosen elementet e sigurise si dhe te gjitha aksesoret e nevojshem te saj.

-Kanatit I deres ka ne brendesi (ndermjet fleteve te llamarines) shufrat metalike te sigurise me diameter minimal prej 16 mm te cilat vendosen ne distance midis tyre minimalisht 30 cm. Ato duhet te saldohen ne kornizen metalike kanatit te deres se blinduar.

-Ndermjet shufrave vendosen materiale mbrojtese termozoluese polisteroli me trashesi minimale $t = 3$ cm. Vendosja e termozoluesit duhet te behet pas saldimit te shufrave metalike dhe perfundimit te punimeve te prodhimit te kornizes metalike te deres.

-Dera metalike mund te jete veshur me llamarine me trashesi jo me te vogel se 2 mm si dhe mund te vendosen mbi te edhe mbulesa te drunjtave me trashesi 2-3 mm (nje nga çdo ane), qe vendosen mbi secilen prej faqeve prej llamarine çeliku, e cila eshte salduar tek shufrat e sigurise me permasa te madhesise se deres.

-Bravat e sigurise se larte se bashku me çelesat sekret montohen ne kornizen e deres me ane te vidave prej çeliku

-Dyert e blinduara duhet te jene te kompletuara me mentesha (te pakten 3 per çdo pjese hapese) ne tre pika ankorimi.

-Kasa e deres duhet te lyhet me boje te emaluar, transparente perpara fiksimit te deres.

-Kur eshte veshur me flete druri mbyllja behet me shirita solide druri te cilat vendosen perreth perimetrit te deres, pune e cila duhet te behet me cilesi te larte sipas te gjitha kerkesave.

-Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e dyerve ne objekt duhet te behen sipas kerkesave teknike.

Fv dyer te brendshme ndertuar me tamburato te rimesuara parashikon:

-Furnizim e dyerve te paketuara me pjese nga fabrikat e prodhimit te porositura me permasat sipas percaktimeve ne projekt. Montimin e tyre ne objekt nga ekip profesionistesh te pajisur me makinerite perkatese qe i pershtaten prodhimit standart me vendin vetem lidhur me lartesine.

-Nje kontratelajo ne dru pishe te stazhionuar (me trashesi 3 cm) e imprenjuar, me permasa sipas gjereses se murit (qe rritet si pasoje e veshjeve te ndryshme te murit), qe do te fiksohet ne mure me fasheta te pershtatshme hekuri (çdo 1 m) dhe me llac cemento.

-Nje telajo druri, qe do te vidhohet ne kontratelajo pas punimeve te suvatimit dhe bojatisjes. Sipas vizatimit te deres ne V.T., telajoja do te pajiset me mentesha dhe bllokuese te pershtatshme sipas tipit te deres, etj.

-Kanat dera me dy flete melamine ndermjet te cileve me shirita druri te plote te pajisur me brava sigurie. Dy panelet e melamines do te kene trashesi min. 8 mm, dhe te gjitha bordurat e deres do te mbroheshen me shirit druri te plote dhe trashesia e pergjithshme e deres do te jete min. 4,5 cm.

-Brava e sigurise dhe celes tip Yale ne tre kopje, doreza tunxhi, dhe piastra e gojeza perkatese, duke perfshire punimet e rifinitures ne murature si dhe çdo paisje tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte .

-Kampione te artikujve te propozuar do t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per aprovim paraprak.

-Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

PUNIME SISTEMIMI

Nenshtrese zhavori

-Hidhet dhe ngjishet zhavori mbi terrenin e ngjeshur mire me perpara, me zhavorr lumi pa perberje argjilore dhe me lartesi sipas udhezimeve ne projekt, si dhe cdo detyrim tjeter per ti dhene fund punes.

-Per analogji mund te perdoret cakull i fraktiruar 3-10cm.

-Garanci per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

Shtrese betoni C 16/20

-Hidhet, ngjishet, nivelohet dhe lemohet betoni me (klase C16/20) me dozimin perkates per m³, me trashesi sipas percaktimeve ne projekt, i hedhur ne veper mbi nje shtrese zhavori dhe i formuar nga shtresa te holla te vibruara mire, duke perfshire cdo detyrim tjeter per mbarimin e punes ne menyre te rregullt.

-Per te krijuar siperfaqe te lemuar pas mpikjes se betonit perhapet shtrese cemento e holle dhe nivelohet me mistri.

-Beton klasa C 16/20 me inerte, konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rere e lare me modul 2,6: Cimento 400 kg 320, rere e lare m³ 0,44, granil m³ 0,70, uje 0,18 m³.

-Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Dyshemeja me pllaka guri me trashesi 6 cm

-Shtresen niveluese me llac bastard me trashesi minimale 2 cm, me dozim: pllaka 1,02 m², llac bastard (m-15) 0,02 m³, cemento (m-400) 4 kg,

-Prerjen me disk ose me gdhendje me cekan guri, te pllakave sipas nevojës se mjedisit te jashtem qe shrohet.

-Realizimin e bojakut te cimentos, ne pershtetshmeni te llojit dhe ngjyres se gurit te perzgjedhurr, aplikimi i tij ne menyre perfekte.

-Cdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te dyshemese ne menyre perfekte dhe te sigurte per punonjesit dhe te tjeret.

-Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

-Dyshemeja me lluster cemento parashikon realizimin e saj me trashesi sipas kerkesave te projektit, mbi nje siperfaqe te realizuar me pare me beton m-100, e zbatuar me llac cimentoje

-m-1:2 , me dozimin perkates, lemimin e siperfaqes me mistri dhe pluhur cimentoje, duke perfshire cdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te dyshemeese ne menyre perfekte. Per rastet qe kerkohet nga projekti lemimi do te realizohet me makineri "Elikopter".

-Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

-Beton marka 16/20 me inerte , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rere e lare me modul 2,6:
---Cimento 400 kg 300 , rere e lare m³ 0,43 , granil m³ 0,69 , uje m³ 0,18.

Markat e betonit

-Beton marka C 12/15 me inerte , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rere e lare me modul 2,6:Cimento 400 kg 260 , rere e lare m³ 0,44 , granil m³ 0,70, uje m³ 0,18.

-Beton marka 20/25 me inerte , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rere e lare me modul 2,6: Cimento 400 kg 370 , rere e lare m³ 0,43, granil m³ 0,69 , uje m³ 0,185.

-Beton marka 25/30 me inerte , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rere e lare me modul 2,6: Cimento 400 kg 465 , rere e lare m³ 0,38 , granil m³ 0,64 , uje m³ 0,195.

Struktura mbajtese beton/arme

Ky paragraf i referohet elementeve strukturor prej betoni dhe beton/arme, duke parashikuar nje fuge teknike (L=1/100h). Struktura duhet te realizohet me themele, skelete me trare, kollona, plinta, shkalle te lidhura ndermjet tyre, dhe te perfshije:

Themele beton/arme

-Realizuar me beton C 10/16 me dozature per m³ sipas pikes 2.1, te armuar ne menyre te rregullt (hekur betoni mesatarisht 40kg/m³) sipas udhezimeve ne vizatime, me beton te hedhur ne shtrese te holla dhe te vibruara mire, me dimensione dhe forma sipas fleteve perkatese te vizatimeve, duke perfshire kallepet, perforcimin, skelen, si dhe cdo gje tjeter te nevojshme per perfundimin e punes dhe realizimin e saj ne menyre perfekte.

-Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Kolona beton/arme brenda ose jashte strukturave te murit,

-Te armuar ne menyre te rregullt (hekur betoni mesatarisht 60kg/m³) sipas udhezimeve ne vizatime, me beton (marka 200) te vibruar mire, me dozature per m³ sipas pikes 3.1.4, duke perfshire kallepet, perforcimin, skelen, perforcimin me hekur si dhe cdo gje tjeter te nevojshme per perfundimin e punes dhe realizimin e saj ne menyre perfekte.

-Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Trare te armuar.

-Te realizuar sipas udhezimeve ne projekt, me beton C16/-20, me dozim per m^3 sipas pikes 2.4, duke perfshire skelat e sherbimit, kallepet, perforcimin, hekurin e armatures (hekur betoni mesatarisht $80kg/m^3$) si dhe cdo detyrim tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

-Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Soleta shkalle te derdhura ne veper

-Midis kateve, realizuar si me siper, por duke perdorur kallepe te pjerreta, bazamake dhe skela te pershtatshme sherbimi.

-Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Trare te derdhur ne veper,

-Te armuar ne menyre te rregullt, deri ne lartesine 4 metra, realizuar me beton (C16/20), me dozim per m^3 sipas pikes 2.4, duke perfshire skelat e sherbimit, kallepet, perforcimet, hekurin e armatures si dhe cdo detyrim tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

-Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Breza te derdhur ne veper,

-Ne te gjitha gjeresine e muratures me trashesi te njejte me ate te soletes nese ka, dhe ne rast se nuk ka jo me shume se 30 cm, armuar ne menyre te rregullt (hekur betoni mesatarisht $60kg/m^3$), realizuar me beton (marka 150), i derdhur ne shtresa te holla te vibruara mire, me dozim per m^3 sipas pikes 2.3, duke perfshire kallepet, perforcimet, hekurin e armatures, skelat e sherbimit ose skelerine si dhe cdo detyrim tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

-Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Hekur betoni

-Punime hekuri per te gjitha strukturat e betonit te perforcuara dhe elementet metalike, qe do te prodhohen ne kantjer, duke marre ne konsiderate te gjitha kerkesat per tipet C-3, me $Ra = 3200 \text{ kg/cm}^2$ dhe jo te ndryshkur, ne madhesi dhe forme sipas udhezimeve te vizatimeve dhe standarteve teknike ligjore per perkuljet, fugat etj. dhe duke patur parasysh sigurimin me certifikata nga laboratoret per te verifikuar qe hekuri i ploteson kushtet per t'u perdorur ne punime, dhe duke perfshire te gjitha detyrimet e tjera per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

-Shufrat e armimit duhet te kthehen sipas masave dhe dimensioneve te vizatimeve dhe ne perputhje te plote me rregulloren e rishikuar se fundi te ASTM, shenimi A-615 me titullin "Specifikimet per shufrat e hekurit per betonarme". Ato duhet te perkulen ne perputhje me vizatimet e ASTM A-305, Çelik 5, me sigma te rrjedhshmerise 3200 kg/cm^2 .

-Hekuri i armimit duhet te jete pa njolla, ndryshk, mbeturina te mullijve, bojera, vajra, graso, dhera ngjitese ose ndonje material tjetër qe mund te demtoje lidhjen midis betonit dhe armimit, ose qe mund te shkaktoje korrozion te armimit, ose shperberje te betonit. Çimento per suva nuk duhet te lejohet. As madhesia dhe as gjatesia e shufrave nuk duhet te jene me pak se madhesia ose gjatesia e treguar ne vizatime.

-Shufrat duhet te perkulen gjithmone ne te ftohte. Shufrat e perkulura jo sic duhet do te perdoren vetem ne se mjetet e perdorura per drejtimin dhe riperkuljen te jene te tilla ,qe te mos demtojne materialin. Asnje armim nuk do te perkulet ne pozita pune pa aprovimin e Supervizorit, ne se eshte ngulur ne betonin e forcuar. Rrezja e brendeshme e perkuljeve nuk duhet te jete me e vogel se dyfishi i diametrit te shufrave per hekur te bute dhe trefishi i diametrit te shufres per hekur shume elastik.

-Armimi duhet te behet me shume kujdes dhe te mbahet nga pajisjet e miratuara ne pozicionin e paraqitura ne skica. Shufrat qe jane parashikuar te jene ne kontakt, duhet te lidhen se bashku me siguri te larte ne te gjitha pikat e kryqezimit, me tel te kalitur hekuri te bute, me diameter.No.16. Kordonat lidhes dhe te tjeret si keto duhet te lidhen fort me shufrat me te cilat jane parashikuar te jene ne kontakt dhe pervec kesaj duhet te lidhen ne menyre te sigurte me tel. Menjehere para betonimit, armimi duhet te kontrollohet per saktesi vendosjeje dhe pastertie dhe do te korigjohet nese eshte e nevojshme.

-Spesoret duhet te jene prej llaci, me cimento dhe rere 1:2 ,ose materiale te tjera te miratuara nga Supervizori.

-Kontraktori duhet te pershtase masa efektive per te siguruar qe perforcimi te qendroje i palevizur gjate forcimit te mases se hedhur dhe vendosjes se betonit.

-Ne soletat e dhena me dy ose me shume shtresa perforcimi, shtresat paralele te hekurit duhet te mbesheten ne pozicion me ndihmen e mbajteseve prej hekuri. Spesoret vendosen ne cdo mbajtese, per te mbeshetur shtresat e armimit nga sforcimi ose armatura.

-Pervec se kur tregohet ndryshe ne skica, gjatesia e nyjeve bashkuese duhet te jete jo me pak se 40 here e diametrit te shufres me diameter me te madh.

-Armimet e ndertuara, kur shtrohen perbri seksioneve te tjera te armimit ,ose kur xhuntohen, duhet te kene nje minimum xhuntimi prej 300mm per shufrat kryesore dhe 150 mm per shufrat e tertorta.

-Perdorimi i mbeturinave te prera nuk do te lejohet.

-Prerja, perkulja dhe vendosja e armimit do te jete pjese e punes brenda cmimit njesi, te vendosur ne Oferten e Tenderit per armimin e hekurit te furnizuar dhe te vene ne pune.

Trotuar me pllaka granili me boje pa borduren e betonit

-siperfaqja ku do te shtrohen pllakat do te jete e rrashet e ngjeshur dhe e forte)kryesisht beton C16/20

-shtrese rere ose material analog (ganil 1) shtroket pa u ngjeshur, nivelohet dhe siper tij vendosen pllakat e granilit ose ndonje material tjetër analog

-Perzgjedhja e pllakave behet nga supervizori pas marrjes se kampioneve

-Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarrës ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

PUNIME TE NDRYSHME

Etiketa do te kete te shkruar emertimin e zyres me gema kapitale.

Etiketat do te jene prej piciglasasi me trashesi $\geq 5\text{mm}$.

Etiketat do te jene bashke me aksesoret e montimit si distancatore dhe bullona me koke inoksidabel.

Ofertuesi merr persiper montimin e tyre ne vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Specifikime të tabelave orientuese:

Tabelat duhet të përmbajnë simbolet ndërkombëtare për secilin tip të tualetit. Sfondi i secilës tabelë duhet të jetë i bardhë, ndërsa simbolet orientuese dhe shkrimet të jenë me ngjyrë e cila do të përzgjidhet në bashkëpunim me porositësin.

Sfondi i secilës tabelë, simbolet orientuese dhe shkrimet të jenë me ngjyrë e cila do të përzgjidhet në bashkëpunim me porositësin. Simbolet në tabela duhet të jenë të dallueshme, edhe për personat me shikim të dobësuar, për këtë arsye ngjyra duhet të jetë në kontrast me ngjyrën e murit dhe të jetë e theksuar. Në tualetet për invalidët sinjalistika duhet të jetë me Braille dhe tabela duhet të jetë e vendosur në derë në lartësi të përshtatshme për shikimin.

Tabela te vogla informuese do te jene me permasa 30cm x 17cm. Ajo do te permbaje numrin e dhomes, funksionin e dhomes dhe emrin e personit qe kryen sherbimin.

Tabela informuese do te jene me permasa 50cm x 80cm. Ajo do te permbaje katin , sherbimet qe ofron ne kat , numrin e dhomes ku kryhet ky sherbim

Tabela ne hyrje do te jene me permasa 50cm x 50cm. Ajo do te permbaje emertimin e qendres shendetsores apo ambulances.

INSTALIMET E UJESJELLESIT DHE KANALIZIMEVE

Saraçineskat për ujin e pijshëm

Saraçineskat janë pajisje të veçanta që do të përdoren për kontrollin e rrjedhjes në tubacionet e ujit. Me anë të saraçineskave mund të ndryshohet madhësia e prurjes që i jepet pjesës tjetër të tubit ose ndërprerjen e plotë të rrjedhjes. Saraçineskat mund të jenë me material bronxi, gize ose PPR. Ato janë të tipit me sferë ose me porte, me bashkim, me filetim ose me flanaxha.

Saraçineskat sipas mënyrës së bashkimit me tubat I ndajmë në lloje: me flanaxhë dhe me fileto.

Saraçineskat përbëhen prej pjesëve të mëposhtme:

- Trupi cilindrik prej gize ose bronxi. Në këtë trup duhet të fiksohen flanaxhat përkatëse, të cilat shërbejnë për lidhjen e saraçineskës me tubacionin e rrjetit.
- Disku ose sfera i cili duhet të sigurojë mbylljen dhe hapjen e saraçineskës. Ato janë me material çeliku ose bronxi dhe duhet të jenë rezistente ndaj korrozionit, goditjeve mekanike, etj
- Volanti apo leva, e cila lidhet me boshtin e rrotullimit dhe realizon hapjen ose mbylljen e diskut nëpërmjet lëvizjes vertikale rrotulluese.
- Kapaku i i saraçineskës, i cili lidhet me anë të bullonave dhe dadove me trupin cilindrik të saraçineskës ose me filetim.

Në vendin e bashkimit të saraçineskës me tubat duhet të vendosen guaino gome në tipet me flanaxha ose fije lini dhe bojë kundra ndryshkut ose pastë, për ato me fileto, për të mos patur rrjedhje të ujit.

Saraçineskat që përdoren në një linjë ujësjellësi duhet të përballojnë një presion 1,5 herë më tepër se presioni I punës. Ato duhet të përballojnë një presion minimal prej 10 atm.

Saraçineskat duhet të sigurojnë rezistencë perfekte ndaj korrozionit, rezistencë ndaj agjentëve kimikë, peshë të lehtë, mundësi të thjeshtë riparimi dhe transporti, jetëgjatësi mbi 25 vjeçare dhe qëndrueshmëri ndaj goditjeve mekanike.

Në raste të veçanta me kërkesë të projektit ose të supervisorit përdoren edhe kundralvolat që janë saraçineska të cilat lejojnë lëvizjen e ujit vetëm në një drejtim. Këto duhet të vendosen në tubin e thithjes së pompave apo në tubin e dërgimit të tyre. Gjithashtu ato mund të vendosen në hyrje të çdo ndërtese për të bërë bllokimin e ujit që futet.

Ato janë të tipit me porte, e cila me anë të një çerniere hapet vetëm në një drejtim. Në rast se uji rrjedh në drejtim të kundërt me atë që kërkohet, bëhet mbyllja e saj me anë të çernierës.

Për sistemin e furnizimit me ujë të ndërtesave, në rastet kur do të përdoren tuba plastike PPR (Polipropilen Random), saraçineskat përkatëse mund të jenë PPR, të cilat plotësojnë kërkesat e cilësisë sipas standartit ISO 9001 dhe DIN 8078 (kërkesat për cilësinë dhe testimin).

Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre në objekt duhet të bëhen sipas kërkesave teknike të supervisorit dhe të projektit.

Një model i saraçineskës që do të përdoret së bashku me çertifikatën e cilësisë, çertifikatën e origjinës, çertifikatën e testimin dhe të garancisë do t'i jepet për shqyrtim Supervisorit për një aprovim para se të vendoset në objekt. Supervisorin mund të bëjë teste plotësuese për të dhënat fizike - mekanike- termike të

tyre, rrjedhje të mundshme si dhe presionin që durojnë pas instalimit (Testi i presionit bëhet me 1.5 herë të presionit të punës).

Depozitat e ujit

Për të siguruar presionin e nevojshëm dhe sasinë e duhur të ujit gjatë gjithë ditës, në një ndërtesë duhet të vendosen depozita ose pompa uji.

Volumi i tyre dhe specifikimet e tjera teknike në lidhje me sasinë dhe presionin e duhur jepen nga projektuesi në funksion të kërkesave ditore për konsum të ujit.

Volumi i Depozitës së ujit përcaktohet me anë të formulave përkatëse në varësi të skemës së përcaktuar në projekt.

a- Në rastin kur në ndërtesë vendoset vetëm Depozita e ujit formula e llogaritjes së volumit do të jetë:

$$V = (0,5-0,8) \times Qd$$

ku Qd është prurja ditore e shprehur në m³

b- Në rastin kur në ndërtesë vendoset Depozita e ujit dhe pompë, formula e llogaritjes së volumit do të jetë:

$$V = (0,2-0,3) \times Qd$$

ku Qd është prurja ditore e shprehur në m³

Vëllimi i Depozitës së ujit kur vendoset në pjesën e sipërme të ndërtesës në çdo rast nuk duhet të jetë më tepër se 3 m³.

Në depozitat e ujit për ndërtesa që kanë kërkesa të veçanta për mbrojtjen kundër zjarrit duhet të mbahet një rezervë e paprekshme që të furnizojë për 10 minuta hidrantet e brendshme të shuarjes së zjarrit.

Depozitat e ujit duhet të jenë me llamarinë të zinkuar, plastikë ose me çelik inoksi. Forma e tyre mund të jetë drejtkëndëshe ose rrethore në varësi të vendit ku do të montohen dhe kërkesave të projektit. Trashësia e materialit të depozitës llogaritet në varësi të volumit të rezervuarit dhe formës së tij por gjithmonë duhet të jetë jo më pak se 1 mm.

Pjesët përbërëse të Depozitës së ujit duhet të jenë si më poshtë:

- 1- Tubi i ushqimit i pajisur me galexhantin notues
- 2- Tubi i shpërndarjes i cili mund të lidhet me tubin e ushqimit duke vendosur para lidhjes një kundërvalvol.
- 3- Tubi kapërderdhës (tepërplotësi) që lidhet me depozitën në nivel jo më poshtë se 150 mm nga mbulesa e saj zgjatet deri në pikën e shkarkimit
- 4- Tubi shkarkimit duhet të jetë i pajisur me ventil saraçineske dhe vendoset në pikën e poshtme të rezervuarit

5- Tubi i sinjalizimit (kur kërkohet nga supervisor) që lidhet 20 - 30 mm më poshtë nga tubi kapërderdhës

6- Galexhanti notues

7- Kazani i mbajtjes së ujit

Diametrat dhe gjatësitë e tubave të mësipërm të cilat janë në varësi të volumit të ujit të depozitës dhe mënyrës së lidhjes me rrjetin e brendshëm të ujësjellësit, jepen në vizatimet teknike përkatëse. Të gjithë tubat mund të jenë prej çeliku të zinkuar, kur përdoren depozita metalike dhe plastike në rast të përdorimit të Depozitave plastike.

Depozitat e ujit duhet të vendosen në pjesë të veçanta të ndërtesës. Në funksion të skemës së zgjedhur nga projektuesi ato mund të vendosen në bodrumin e ndërtesës ose mbi tavanin e katit të sipërm. Ato vendosen mbi binarë druri të lidhur me fletë llamarine 2 mm, binarët sigurojnë mbrojtjen e soletës nga lagështia, që krijohet prej kondensimit të ujit në sipërfaqet e depozitës ose prej rrjedhjeve të mundshme të depozitës.

Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e Depozitës së ujit në objekt, duhet të bëhen dhe sipas kërkesave teknike të supervisorit dhe të projektit. Një katalog me të dhënat teknike të saj, çertifikata e cilësisë, origjinës së materialit, garancia minimale prej 1 vit dhe çertifikata e testimit të bërë nga prodhuesi, do t'i jepet për shqyrtim supervisorit për një aprovim para se të vendoset në objekt.

Pompat e ujit

Për të siguruar presionin dhe prurjen e duhur gjatë gjithë ditës në një ndërtesë mund të vendosen, sipas kërkesës së projektit, pompa uji të tipit centrifugal. Pompat duhet të jenë të pajisura me matësin e ujit, matësin e presionit, tubat përkatës të lidhjes së pompës me sistemin e ujësjellësit, panelin elektrik përkatës të tyre, me sistemin e mbrojtjes rele, të mbrojtjes termike, si dhe me sistemin e kontrollit automatik të punës.

Presioni i kërkuar, prurja, fuqia e tyre dhe specifikimet e tjera teknike, duhet të jepen në vizatimet teknike nga projektuesi në funksion të kërkesave ditore për konsum të ujit.

Kur në rrjetin e brendshëm të ujësjellësit ka vetëm pompa, prurja e pompës, duhet të jetë e barabartë me prurjen maksimale ditore të ujit në sekondë.

Kur në rrjetin e brendshëm të ujësjellësit ka depozitë uji dhe pompë, prurja e pompës duhet ti përgjigjet grafikut ditor të përdorimit dhe dërgimit të ujit nëpër ndërtesë.

Në përcaktimin e lartësisë së ngritjes së pompës (presioni i kërkuar) duhet të merret në konsideratë lartësia e ndërtesës, presioni i ujit në rrjetin e jashtëm të ujësjellësit si dhe humbjet lokale nëpër kthesat, daljet, në çdo pjesë të ndërtesës.

Fuqia e pompës së ujit përcaktohet me anë të formulës përkatëse si më poshtë:

$$N = Q \times H / 102 \times \eta$$

Ku: Q = prurja e ujit që duhet të pompohet në l/sek

H = Lartësia e dërgimit të ujit

n = rendimenti i pompës i cili duhet të jetë më tepër se 65 % dhe jepet nga prodhuesi i pompës.

Tubat e shkarkimit

Për shkarkimet e ujrave do të përdoren tuba plastike që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas standartit ISO 4427 dhe prEN 12201.

Këto tuba duhet të sigurojnë rezistence perfekte ndaj korrozionit, rezistencë të lartë ndaj agjentëve kimike, peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe lidhje, ngjitje të thjeshtë dhe të shpejtë.

Përmasat e tubave do të jenë në funksion të sasisë llogaritëse të ujit të ndotur, shpejtësisë së lëvizjes dhe vizatimit teknike. Të dhënat mbi diametrin e jashtëm të tubit, presionin, emrin e prodhuesit, standartit që i referohen, viti i prodhimit, etj duhet të jepen të stampuara në çdo tub.

Gjatësia e tubave duhet të jetë 6-10 m kurse diametri dhe spesori duhet të jenë sipas të dhënave në vizatimet teknike. Të dhënat mbi diametrin e jashtëm të tubit, presionin, emrin e prodhuesit, standartit që i referohen, viti i prodhimit, etj duhet të jepen të stampuara në çdo tub.

Tubat e shkarkimit duhet të vendosen në të gjithë lartësinë e ndërtesës, në formën e kollonave, në ato nyje sanitare ku aparatet janë më të grupuara dhe mundësisht sa më afër atyre nyjeve që mbledhin me shumë ujëra të ndotura dhe ndotje më të mëdha. Tubat e shkarkimit lidhen me pajisjet sanitare ose grup pajisjesh në çdo kat me anë të tubave të dërgimit. Lidhja e tubave të dërgimit me kollonat e shkarkimit duhet të bëhet me tridegëshe të pjerrëta nën një kënd 45 ose 60 gradë. Uk këshillohet lidhja e tubave në kënd 90 gradë. Tubat e dërgimit mund të shtrohen anës mureve, mbi ose nën soletë duke mbajtur parasysht kushtet e caktuara për montimin e rrjetit të brëndshëm të kanalizimeve. Tubat e dërgimit duhet të jenë tuba PVC me të njëjtat karakteristika teknike të dhëna më sipër. Gjatësia e këtyre tubave nuk duhet të jetë më tepër se 10 m. Diametri i tyre do të jetë në funksion të daljeve të pajisjeve sanitare që janë vendosur.

Për të pakësuar numrin e kollonave duhet që pajisjet sanitare të grupohen dhe të vendosen njëri mbi tjetrin nga kati në kat të ndërtesës. Çdo kollonë vertikale e shkarkimit pajiset me pika kontrolli të cilat duhet të vendosen në çdo dy katë duke filluar nga pjesa e poshtme e kollonës. Diametri i kollonave të shkarkimit merret i njëjtë për të gjithë lartësinë e ndërtesës dhe në asnjë mënyrë më i vogël se tubi më i madh i dërgimit të ujrave të ndotura që lidhet me të. Nuk lejohet përdorimi i tubave të shkarkimit me diametër më të vogël se 50 mm.

Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre në objekt duhet të bëhen sipas kërkesave teknike të supervisorit dhe të projektit. Bashkimet e tubave të shkarkimit duhet të bëhen me mastik të përshtatshëm për tuba PVC i rekomanduar nga prodhuesi i tubave. Kur toka në dyshtet e katit përdhe është e dobët, tubacionet e shkarkimit duhet të vendosen në kanal betoni ose tulle.

Provat hidraulike bëhen me presion provë 25% më të lartë se presioni i punës. Ato bëhen për të parë qëndrueshmërinë e rrjetit, si dhe rrjedhjet e mundshme që mund të ndodhin në tabacionet.

Një model i tubit PVC që do të përdoret sëbashku me çertifikatën e cilësisë, çertifikatën e origjinës, çertifikatën e testimit dhe të garancisë së tubave do ti jepet për shqyrtim Supervisorit për një aprovim para se të vendoset në objekt. Supervisorin mund të bëjë teste plotësuese për të dhënat fizike - mekanike të tubave dhe të materialit ngjites të tyre.

Rakorderitë për tubat e shkarkimit të ujrave

Për lidhjen e tubave të shkarkimit me njëri tjetrin si dhe me pajisjet sanitare apo grupet e tyre do të përdoren rakorderitë përkatëse me material plastik PVC, që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas standartit ISO 4427 dhe prEN 12201.

Këto rakoredri (pjesë bashkuese) duhet të sigurojnë rezistencë ndaj korrozionit, rezistencë të lartë ndaj agjentëve kimike, peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe lidhje, ngjitje të thjeshtë dhe të shpejtë.

Përmasat (diametri) e tyre do të jenë në funksion të sasisë llogaritëse të ujit të ndotur, llojit të pajisjeve sanitare, shpejtësisë së lëvizjes së ujit dhe diametrave të tubave përkatës. Gjatë llogaritjeve, shpejtësia e lëvizjes së ujit duhet të merret 1-2 m/sek kurse shkalla e mbushjes do të jetë 0,5-0,8 e seksionit të tubit.

Diametri dhe spesori i tyre duhet të jenë sipas të dhënave në vizatimet teknike. Të dhënat mbi diametrin e jashtëm, gjatësitë, presionin, emrin e prodhuesit, standartit që i referohen, viti i prodhimit, etj duhet të jepen të stampuara në çdo rakorderi.

Rakorderitë e bashkimit të tubave duhet të montohen në të gjithë vendet ku bëhet bashkimi me tubat e dërgimit të ujrave të ndotura. Lidhja e tubave të dërgimit me kollonat e shkarkimit, duhet të bëhet me tridegëshe të pjerrëta ose bryla të thjeshtë nën një kënd 45 ose 60 gradë.

Rakorderitë e bashkimit duhet të jenë tuba PVC me të njëjtat karakteristika teknike të dhëna më sipër. Gjatësia e tyre duhet të jetë sipas kërkesave të projektit. Diametri i tyre do të jetë në funksion të daljeve të pajisjeve sanitare që janë vendosur.

Diametri i rakorderive duhet të jetë i njëjtë me diametrin e tubit të shkarkimit ku do të lidhet dhe në asnjë mënyrë më i vogël se tubi më i madh i dërgimit të ujrave të ndotura që lidhet me të. Në rastet e ndryshimit të diametrit të tubave të shkarkimit dhe të dërgimit, rakorderitë duhet t'i përshtaten secilit prej tyre.

Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre në objekt duhet të bëhen sipas kërkesave teknike të supervizorit dhe të projektit. Bashkimet e rakorderive me tubat e shkarkimit, bëhen me mastik të përshtatshëm për tuba PVC i rekomanduar nga prodhuesi i tubave.

Një model i rakorderive përkatëse PVC që do të përdoret, së bashku me çertifikatën e cilësisë, çertifikatën e origjinës, çertifikatën e testimit dhe të garancisë së tubave do ti jepet për shqyrtim supervizorit për një aprovim para se të vendoset në objekt. Me kërkesë të veçantë të Supervizorit, mund të bëhen teste plotësuese për të dhënat fizike - mekanike të tubave dhe të materialit ngjites të tyre.

Tubat e ajrimit

Tubat e ajrimit janë zgjatim në pjesën e sipërme të kollonave të shkarkimit dhe duhet të nxirren 70 - 100 cm me lart se pjesa e sipërme e çatise ose terraces se ndërteses.

Ato duhet të shërbejnë për ajrimin e rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të kanalizimeve.

Ky ajrim është i domosdoshëm sepse me anë të tij bëhet e mundur largimi i gazrave të krijuara në kollonat e shkarkimit si dhe i avujve të ndryshëm që janë të dëmshëm për jetën e banorëve.

Gjithashtu, Tubat e ajrimit do të shërbejnë për të bashkuar kollonat e kanalizimeve me atmosferën për të mënjeluar ndërprerjen e punës së sifonëve në pajisjet hidrosanitare.

Tubat e ajrimit duhet të kenë diametrin e brendshëm njëlloj me diametrin e kollonës së shkarkimit. Në rast se godina ndërtohet në vënde të flohta, Diametri i tubit të ajrimit duhet të jetë 50 mm më i madh se diametri i kollonës së shkarkimit.

Tubat e ajrimit mund të jenë prej gize, prej lllmarine të zinkuar me trashësi jo më të vogël se 0,6 mm, ose prej eterniti e çeliku. Materialet që përdoren për këto tuba duhet të jenë rezistent ndaj korrozionit, agjentëve atmosferike, gazrave të ndryshëm që dalin nga kollonat e shkarkimit (amoniak, metan, acetilen, etj) si dhe avujve të hidrokarburëve që mund të krijohen.

Në majë të tubave të ajrimit duhet të vendoset një kapuç (shih fig.), i cili pengon hyrjen në tub të ujrave të shiut dhe deborës si dhe përmirëson ajrimin e kollonës së shkarkimit.

Për të përmirësuar dhe shpejtuar ajrimin e kollonave të shkarkimit (në varësi të rëndësisë së objektit dhe kërkesave të projektit, në tubat e ajrimit, mund të montohen edhe pajisje elikoidale të cilat bëjnë largimin e shpejtë të gazrave dhe avujve që vinë nga kollonat e shkarkimit.

Në rast se afër tubave të ajrimit ndodhen dritare ose ballkone të ndërtesave fqinje, atëherë lartësia e tubave të ajrimit duhet të jetë më e madhe se lartësia e ndërtesës fqinje ose tubat e ajrimit, duhet të jenë më tepër se 4 m larg tyre.

Një grup aparatësh mund të kenë dy tuba ajrimi.

Tubat e ajrimit duhet të montohen me kujdes në pjesën e sipërme të kollonave të shkarkimit në mënyrë që të mos shkëputen ose të dëmtohen nga erërat e forta që mund të fryjnë. Ato montohen në pozicion vertikal

Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre në objekt duhet të bëhen sipas kërkesave teknike të supervisorit dhe të projektit. Një model i tubit të ajrimit do të jepet për shqyrtim supervisorit për një aprovim paraprak para se të vendoset në objekt.

Piletat

Për shkarkimet e ujrave të dyshemeve do të përdoren piletat të cilat plotësojnë të gjitha kërkesat e cilesive sipas standartit ISO dhe prEN 12201. Piletat mund të jenë me material plastik, inoksi dhe bronxi.

Piletat duhet të sigurojnë percjellshmeri të lartë të ujrave, rezistence ndaj korrozionit dhe agjentëve kimike, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe bashkimi.

Piletat përbehen nga:

- **Gropa mbledhese** në formë sifoni e ujrave me $d = 50 - 100$ mm. Permasat e saj do të jenë në funksion të sasise së ujit që shkarkojnë dhe vendit ku do të vendosen. Zakonisht ato janë rrethore me diameter.

- **Tubi i daljes së ujrave** me $d = 45 - 70$ mm. Tubi i daljes është një trup me gropën mbledhese. Permasat e tij do të jenë në funksion të sasise së ujit që shkarkojnë, llojit të materialit të piletës dhe kollonës me të cilën lidhet.

- **Kapaku me vrima** i cili vendoset në formë të lirshme mbi gropën mbledhese. Permasat e tij do të jenë në funksion të permasave të gropës mbledhese të ujrave. Madhësia e vrimave dhe forma e tyre varen nga sasia e ujit që shkarkohet në pilete dhe vendit ku do të vendosen. Zakonisht ato janë rrethore me diameter, por në rastet e përdorimit në tarracat e pallateve, përdoren plastike katrore.

Piletat e shkarkimit duhet te vendosen ne pjesen me te ulet te siperfaqes ku do te mblidhen ujrato. Zakonisht ato nuk vendosen ne afersi te bashkimit te dyshemese me muret, por sa me afer mesit te dyshemese.

Piletat e shkarkimit lidhen me kollonat e shkarkimit me ane te nje tubi PVC ose xingato. Lidhja e piletave me kollonat e shkarkimit mund te behen me tridegeshe te pjerrreta nen nje kend 45 ose 60 grade. Tubi i lidhjes duhet te jete PVC me te njejtat karakteristika teknike te tubave te shkarkimit te ujrave. Gjatesia e ketyre tubave eshte 20 - 30 cm. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te piletes ku jane vendosur. Ne rastet e ndryshimit te dimaterit te piletes me ate te tubit te dergimit do te perdoren reduksionet perkatese.

Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre ne objekt duhet te behen sipas kerkesave teknike te supervizorit dhe te projektit. Bashkimet e piletes me tubat e shkarkimit behen me mastik te pershtatshem per tuba PVC, i rekomanduar nga prodhuesi i tubave.

Nje model i piletes qe do te perdoret sebashku me certifikaten e cilesise, certifikaten e origjines, certifikaten e testimit dhe te garancise do ti jepet per shqyrtim Supervizorit per nje aprovim para se te vendoset ne objekt. Supervizori mund te beje testime plotesuese per te dhenat fizike-mekanike te materialit ngjites te tyre.

Izolimi i tubave

Per te siguruar mosrrjedhjen e ujrave neper muret apo dyshemete e ndertesave duhet te merren masa te forta per izolimin e tubave. Izolimi i tubave behet per keto arsye. Tubat izoloohen edhe per t'u mbrojtur nga korrozioni

- **Per te eliminuar rrjedhjen ne bashkimet e tubave me rakorderite.** Ne kete rast duhet te behet izolimi i tyre me fije lini dhe me material plastik te percaktuar nga prodhuesi. Materiali izolues vendoset me kujdes neper filetot e tubit dhe te rakorderise perkatese dhe lyhet me bojë kundra ndryshkut, perpara se te behet filetimi i te dy pjesëve.

Ne rastet e perdorimit te tubave me material PPR, ky izolim sigurohet me ane te ngjitjes qe eshte pershkruar ne zehrin 94.

Ne rastet e perdorimit te tubave te tipit me flanaxha ne bashkimet e tyre perdoret guanicion gome ose amianti i cili vendoset ndermjet flanaxhave te tyre.

Ne te gjitha rastet e permendura me sipër duhet te behen provat per rrjedhje ne presion provë te barabartë me 1,5 herë te presionit te punës.

- **Per te eliminuar lagjen e mureve apo te dyshemeve nga kondensimi i ujrave gjate ngrohjes ose ftohjes se tubave, keta mbeshillen me ane te nje pelhure te thjeshte ose me material te gomuuar.**

- **Per te mbrojtur tubat nga ndryshku**

Izolimi i tubave duhet te siguroje moslagjen e mureve, mosrrjedhje te ujit ne zonat e bashkimit te tyre dhe rezistencë te tubit ndaj korrozionit dhe ndryshkut.

Në rast se në projekt kërkohet izolimi i tubave me bitum ajo duhet të bëhet sipas standarteve teknike dhe kërkesave të supervizorit. Përshkrimi i mënyrës së izolimit me bitum jepet në projekt (mënyra e lyerjes me prajmer, shtresat e izolimit me bitum, lloji i bitumit dhe materiali i izolimit.

Të gjitha punët e lidhura me izolimin e tubave duhet të bëhen sipas kërkesave teknike të supervizorit dhe të projektit.

Pusetat

Sipas funksionit që ato kryejnë klasifikohen:

- Puseta kontrolli për sistemin e ujërave të zeza
- Puseta mbledhëse për ujërat e shiut dhe të drenazhimeve
- Puseta komandimi për tubacionin e ujësjellësit

Të gjitha tipet e pusetave të lartpërmendura mund të jenë me mure të tilla me elemente të parafabrikuara betoni, ose me beton të derdhur në vend.

Për pusetat me elemente të parafabrikuar ndiqet procedura e mëposhtme e punës:

- Gërmim me seksion të caktuar në terren të çfarëdolloj natyre dhe konsistencë duke përfshirë spostimin e dherave të tepërta

- Vendosja e elementëve të parafabrikuar në mënyrë të saktë dhe bashkimi i tyre me anë të llaçit
- Futja e tubacionit të sistemit dhe mbyllja e hapësirave me llaç.

Pusetat në vetvete kanë dy elemente të rëndësishëm që do të përshkruajmë më poshtë:

- Elementi i ndërtimit të pusetës
- Kapaku i pusetës
- Shkallët zbritëse (për puseta të thella mbi 1 m)

Ndërtimi i pusetës bëhet duke u bazuar në radhën dhe me elementët e mëposhtëm:

- Gërmim me seksion të caktuar në terren të çfarëdolloj natyre duke përfshirë spostimin e dherave të tepërta

- Shtresë zhavori lumi

- Shtresë betoni të padepërtueshëm nga uji për dyshemene me beton m-200 me dozim sipas pikës 4.1.4 duke shtuar në përzierjen e tij solucion që i jep atij padepërtueshmërinë nga uji.

- Muraturë betoni të padepërtueshëm nga uji, me beton m-200 me dozim sipas pikës 4.1.4 duke shtuar në përzierjen e tij solucion që i jep atij padepërtueshmërinë nga uji.

- Shtresë e sipërme betoni e padepërtueshme nga uji, me beton m-200 me dozim sipas pikës 4.1.4 duke shtuar në përzierjen e tij solucion që i jep atij padepërtueshmërinë nga uji. Së bashku me të betonohet edhe korniza mbështetëse për kapakun e pusetës.

- Vendosja e kapakut të pusetës.

Kapaku i pusetës përbëhet në vetvete nga dy elementë:

- Korniza ku ai fle

- Kapaku

Madhësia e kapakut të pusetës varet nga funksioni i saj, por duhet që të mundësojë hyrje / dalje të lirshme të një personit.

Materiali nga i cili është prodhuar si korniza ashtu edhe kapaku duhet të jenë prej gize.

Pusetat duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme teknike:

- Ngarkesën e mbajtjes, të jashtme

- Presionin e dheut

- Presionin e ujit

Ngarkesa e mbajtjes kalsifikohet nga tre klasa A, B, C, ku:

- klasa A është për puseta ku kalojnë vetëm këmbësorë dhe duhet të mbajë deri në 15 t

- klasa B është për puseta ku kalojnë qarkullojnë automjete dhe duhet të mbajë deri në 25 t

- klasa C është për puseta ku kalojnë qarkullojnë automjete dhe duhet të mbajë deri në 40 t

Koeficienti i presioni duhet të jetë 2 t/m^3 .

Koeficienti i presioni të ujit duhet të jetë 1 t/m^3 : nga jashtë deri në 0.5 m nën nivelin e sipërm të kapakut dhe për nga brenda me pusete të mbushur plotë.

Shkallët e puseta duhet të vendosen në pusetat me thellësi me të madhe se 1 m dhe që shërbejnë për të lehtësuar hyrje / daljen nga puseta.

Materiali që do të përdoret për realizimin e shkallëve duhet të jetë rezistent ndaj korozionit (zing). Fiksimi i tyre bëhet gjatë procesit të betonimit të mureve, duke i betonuar një pjesë.

Përmasat e pusetës varen nga funksioni i saj dhe duhet të përcaktohen nga inxhinieri projektues.

Në figurat e mëposhtme paraqiten disa tipe pusetash, kapak, korniza me të dhëna teknike përkatëse.

Te dhëna teknike të një kornize

Lartësia 150 mm

Thellësia e futjes 13 mm

Ø i jashtëm 789 mm


Ø i brendshëm 625 mm



Të dhëna teknike për kapak pusete prej gize

Øe rrethit që funksion 46 cm


Sipërfaqja e cila fle në kornizë $60.000 \text{ mm}^2 = 6,7 \text{ N/mm}^2$



Pozicioni i hapjeve 3 x 120°

Fuqia për mbyllje rreth. 20 kg

Fuqia për hapje rreth. 20 kg




Në fig e mësipërme jepet një detaj i një grope mbledhëse të ujëra të shiut me gotë moskthimi.

Në figurat e mëposhtme paraqiten disa shëmbuj për sistemet e mbledhjes e të largimit të ujërave të shiut.



Pusetat e ujërave të shiut duhet të jenë në formë katrori me thellësi jo me pak se 50cm. Përmasat janë 50x50x50, mbuluar me kapak zgare hekuri ose gize të çarat me kapakun prej zgare janë nga 25 deri 35 mm.



WC dhe kaseta e shkarkimit

Në ambientet e larjes apo dhomat e tualetit parashikohet edhe vendosja e WC-ve. Ato janë me material porcelani me të dhënat e standarteve teknike ndërkombëtare dhe duhet të përcaktohen në projekt nga projektuesi. Ato mund të jenë të tipit oriental ose alla frënga. Në shkolla rekomandohen të tipit oriental WC, ku vendoset direkt në dysheme dhe montohet llaç çimento sipas udhëzimeve të dhëna nga supervizori.

WC tip alla frënga përdoren në kopshte dhe për personelin pedagogjik dhe antikapatët, fiksohen në dysheme ose në mur me fasheta tunxhi, vida dhe tapa me fileto pa ndërprerë veshjen me pllaka të murit. Para fiksimit të tyre duhet të bëhet bashkimi me tubat e shkarkimit të ujrave. WC mund të jetë me dalje nga poshtë trupit të saj ose me dalje anësore në pjesën e pasme të WC. Në WC me dalje anësore tubi i daljes duhet të jetë në lartësinë 19 cm nga dyshemeja.

Në pjesën më të ulët të sipërfaqes së gropës mbledhëse është një vrimë me diametër minimal 90 mm. Pjesa e sipërme e WC-së është në formë vezake ose rrethore në varësi të kërkesës së projektit, llojit dhe modelit të tyre. WC tip alla frënga janë me lartësi 38-40 cm dhe vendosen sipas kërkesës së projektit dhe Supervizorit. Distanca horizontale e vendosjes së tyre nga pajisjet e tjera hidrosanitare (Lavaman, bide, etj) duhet të jetë të paktën 30 cm.

WC-ja duhet të sigurojë percjellshmëri të lartë të ujrave, rezistence ndaj goditjeve mekanike, mbrojtje izoluese ndaj ujrave, rezistencë ndaj korrozionit dhe agjentëve kimike, lehtësi gjatë punës në to dhe mundësi të thjeshta riparimi.



WC-ja lidhet me tubat e shkarkimit të ujrave me anë të tubit në formë sifoni. Tubi i lidhjes së WC me tubat e shkarkimit duhet të jetë PVC me të njëjtat karakteristika teknike të tubave të shkarkimit të ujrave. Diametri i tyre do të jetë në funksion të daljeve të WC (zakonisht ato janë 100-110 mm).

WC-ja lidhet me sistemin e furnizimit me uje me anë të kasetës së shkarkimit e cila mund të instalohet direkt mbi WC ose në mur e ndarë nga WC-ja. Kjo varet nga lloji i këtyre pajisjeve. Kaseta e shkarkimit vendoset në lartësinë rreth 1,5 m lart nga dyshemeja (rasti kur është e ndarë). Ajo mund të jetë porcelani, metalike ose plastike. Lloji i materialit të saj duhet të përcaktohet në projekt. Tubi i shkarkimit fiksohet në mur me fasheta të forta xingato, me vida dhe tapa me fileto në çdo 50 cm.

Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e WC duhet të bëhen sipas kërkesave teknike të supervisorit dhe të projektit. Bashkimi i WC-ve me tubat e shkarkimit duhet të bëhet me mastik të përshtatshëm për tuba PVC, i rekomanduar nga prodhuesi i tubave.

Një model i WC që do të përdoret sëbashku me çertifikaten e cilësisë, çertifikatën e origjinës, çertifikaten e testimit dhe të garancisë do t'i jepet për shqyrtim Supervisorit për një aprovim para se të vendoset në objekt. Të dhënat teknike të WC duke përfshirë edhe modelin e tij, emrin e prodhuesit, standartit që i referohen, viti i prodhimit, etj duhet të jepen në katalogun përkatës që shoqëron mallin. Supervisorit mund të bëjë teste plotësuese për të dhënat fizike-mekanike të tyre.

Në figurat e mëposhtme paraqiten dy tipe WC, ajo tip alla Turke dhe ajo tip alla Frënga.



Pisuarët

Në ambientet e larjes apo dhomat e tualetit të djemve parashikohet edhe vendosja e Pisuarëve. Ato janë me material porcelani me të dhënat e standarteve teknike ndërkombëtare dhe duhet të përcaktohet në projekt nga projektuesi.

Pisuarët fiksohen në mur me fasheta tunxhi, vida dhe tapa me fileto pa ndërprerë veshjen me pllaka të murit. Para fiksimit të tyre duhet të bëhet bashkimi me tubat e shkarkimit të ujrave.

Në pjesën më të ulët të sipërfaqes së gropës mbledhëse është një vrimë me diametër minimal 50 mm. Pjesa e sipërme e Pisuarit është në formë vezake ose rrethore në varësi të kërkesës së projektit, llojit dhe modelit të tyre. Pisuaret vendosen në lartësi 55-70 cm sipas kërkesës së projektit dhe Supervisorit. Distanca horizontale e vendosjes së tyre nga pajisjet e tjera hidrosanitare (Lavaman, bide, etj) duhet të jetë të paktën 30 cm. Ato mund të vendosen në ambiente të veçanta.


Pisuaret duhet të sigurojnë përcjellshmëri të lartë të ujrave, rezistencë ndaj goditjeve mekanike, rezistencë ndaj korrozionit dhe agjentëve kimike, lehtësi gjatë punës në to dhe mundësi të thjeshta riparimi.

Pisuari lidhet me tubat e shkarkimit të ujrave me anë të tubit në formë sifoni. Tubi i lidhjes së WC më tubat e shkarkimit duhet të jetë PVC me të njëjtat karakteristika teknike të tubave të shkarkimit të ujrave. Diametri i tyre do të jetë në funksion të daljes së pisuarit por jo më i vogël se 50 mm.

Pisuari lidhet me sistemin e furnizimit me ujë direkt nga tubacioni duke vendosur saraçinskë, ose me anë të kasetës së shkarkimit, e cila instalohet në mur e ndarë nga Pisuari. Kasetja e shkarkimit vendoset në lartësinë 1,5 m lart nga dyshemeja. Ajo mund të jetë porcelani, metalike ose plastike. Lloji i materialit të saj duhet të përcaktohet në projekt. Tubi i shkarkimit fiksohet në mur me fasheta të forta xingato, me vida dhe tapa me fileto në çdo 50 cm.

Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e Pisuareve duhet të bëhen sipas kërkesave teknike të supervisorit dhe të projektit. Bashkimet e tubit të daljes së Pisuarit me tubat e shkarkimit bëhen me tubat përkatës dhe me mastik të përshtatshëm për tuba PVC i rekomanduar nga prodhuesi i tubave.

Një model i Pisuarit që do të përdoret së bashku me çertifikatën e cilësisë, çertifikatën e origjinës, çertifikatën e testimit dhe të garancisë do ti jepet për shqyrtim Supervisorit për një aprovim para se të vendoset në objekt. Të dhënat teknike duke përfshirë edhe modelin e tij, emrin e prodhuesit, standartit që i referohen, viti i prodhimit, etj duhet të jepen në katalogun përkatës që shoqëron mallin. Supervisorit mund të bëjë teste plotësuese për të dhënat fizike-mekanike të tyre.



Lavamanet

Në ambientet e larjes apo dhomat e tualetit, gjithmonë duhet të parashikohen pajisjet hidrosanitare përkatëse (lavamanet) të cilat shërbejnë si vende për larjen e duarve dhe fytyrës së fëmijëve. Lavamanet mund të jenë metalike, porcelani, muri tulle i suvatuar e veshur me pllaka ose të montuar në vepër. Lloji i materialit përbërës të tyre duhet të përcaktohet në projekt nga projektuesi.

Lavamanët duhet të sigurojnë përcjellshmëri të lartë të ujrave, rezistencë ndaj goditjeve mekanike, mbrojtje izoluese ndaj ujrave, eliminim të zhurmave gjatë punës, rezistencë ndaj korrozionit dhe agjentëve kimike, lehtësi gjatë punës në to dhe mundësi të thjeshta riparimi.

Lavamanet e porcelanit dhe mbështetësja e tyre fiksohen në mur me fasheta tunxhi, vida dhe tapa me fletë pa ndërprerë veshjen me pllaka të murit. Pas fiksimit të saj në mur duhet të bëhet vendosja e rubinetave me tunxh të kromuar mbi lavaman dhe bashkimi i lavamanit me tubat e kanalizimit të sifonit dhe tubat e shkarkimit të ujrave. Njëkohësisht lavamani duhet të pajiset edhe me piletën e tij metalike. Pileta duhet të vendoset në pjesën më të ulët të sipërfaqes së gropës mbledhëse ku është hapur një vrimë me përmasat e piletës. Lavamani ka një gropë mbledhëse me përmasa 40/60 x 36-45 cm në varësi të llojit dhe modelit të zgjedhur. Përmasat e lavamanit janë në varësi të llojit dhe modelit të tyre. Lavamanet vendosen në lartësi 75- 85 cm sipas kërkesës së projektit dhe Supervizorit. Distanca horizontale e vendosjes së tyre nga pajisjet e tjera hidrosanitare (bide, WC, etj) duhet të jetë të paktën 30 cm

Lavamanet e pregatitur në vepër me përmasa dhe formë sipas udhëzimeve të projektit dhe supervizorit formohen nga pjesët e mëposhtme:

- 2 parapete të realizuara në mur me tulla të plota dhe llaç bastard me dozim për m³ sipas kushteve teknike të pregatitjes së llaçit.

- Soletë të armatuar dobët realizuar me beton M-200 duke përfshirë kallëpet, përforcimet, etj

- Grupi i lavamanit me tapë me xinxhir, sifon, tuba, etj

- Pllakat majolike të cilësisë së parë që do të përdoren për veshjet e sipërfaqeve horizontale dhe vertikale


Lavamanet lidhen me tubat e shkarkimit të ujrave me anë të piletës, tubit në formë sifoni prej materiali PVC-je. Lidhja e mësipërme mund të bëhet me tridegëshe të pjerrëta nën një kënd 45 ose 60 gradë. Tubi i lidhjes duhet të jetë PVC me të njëjtat karakteristika teknike të tubave të shkarkimit të ujrave. Gjatësia e këtyre tubave është 20 - 40 cm. Diametri i tyre do të jetë në funksion të daljeve të piletes ku janë vendosur

Lavamanet lidhen me sistemin e furnizimit me ujë me anë të dy tubave fleksibel me gjatësi 30 - 50 cm dhe diameter 1/2 ", të cilët bëjnë lidhjen e rubinetit me tubat e furnizimit me ujë të ngrohtë dhe ujit të zakonshëm. Në vendin e lidhjes së rubinetit me lavamanin duhet të vendosen gomina të përshtatshme, për të mos bërë lejimin e rrjedhjes së ujrave.

Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre në objekt bëhen sipas kërkesave teknike të supervizorit dhe të projektit. Bashkimet e lavamanit me tubat e shkarkimit duhet të bëhen me tubat përkatës dhe me mastik të përshtatshëm për tuba PVC i rekomanduar nga prodhuesi i tubave.

Një model i lavamanit që do të përdoret sëbashku me çertifikatën e cilësisë, çertifikatën e origjinës, çertifikatën e testimit dhe të garancisë do të jepet për shqyrtim Supervizorit për një aprovim para se të vendoset në objekt. Supervizori mund të bëjë teste plotësuese për të dhënat fizike-mekanike të tyre.

Në figurën e mëposhtme paraqitet një lavaman porcelani, i cili është inkastruar në mur.



Rubinetat

Rubinetat janë pajisje të veçanta që përdoren për kontrollin e rrjedhjes në tubacionet e ujit. Ato vendosen në pajisjet hidrosanitare përkatëse (lavamane, lavapjata ose bide) dhe mund të jenë të thjeshta (përdoren vetëm për ujin e pijshëm) ose të përbëra (përdoren për sistemet e ujit të ftohtë dhe të ngrohtë). Për rubinetat e thjeshta mund ti referoheni zërit 95 (Saraçineskat). Me anë të rubinetave mund të ndryshohet madhësia e prurjes që del në pajisjen hidrosanitare si dhe mund të bëhet edhe rregullimi i temperaturës së ujit që përdoret. Rubinetat mund të jenë me material bronxi, gize ose të nikeluara. Ato janë të tipit me **sferë** ose **portë**.

Grupi i Rubinetës është tip me lidhje tubi, ose dy lidhje rrethore, i cili përbëhet prej pjesëve të mëposhtme:

- Trupi prej gize ose bronxi. Forma dhe lloji i trupit të rubinetës janë të ndryshme. Ngjyra, forma dhe tipi janë të përcaktuara në projekt ose duhet të përcaktohen nga Investitori.
- Disku ose sfera, që duhet të sigurojë mbylljen dhe hapjen e rubinetës për ujin e ftohtë ose të ngrohtë duke bërë edhe rregullimin e sasisë që del nga rubineta. Ato janë me material çeliku ose bronxi dhe duhet të jenë rezistencë ndaj korrozionit, goditjeve mekanike, etj
- Leva e cila lidhet me boshtin e rrotullimit dhe realizon hapjen ose mbylljen e diskut.
- Filtri i ujit i cili vendoset me filetim në dalje të rubinetës dhe siguron pastrimin e ujit nga lëndë të ndryshme minerale apo kriprat që shoqërojnë ujin e pijshëm
- Tubat fleksibël me gjatësi 30-50 cm të cilët bëjnë lidhjen e rubinetës me tubat e furnizimit me ujë. Tubat fleksibël kanë diametrin 1/2" ose 3/8" në varësi të llojit të rubinetës dhe të tubave

Në vendin e bashkimit të rubinetave me pajisjen hidrosanitare dhe me tubat lidhës duhet të vendosen gominat përkatëse të cilat nuk lejojnë rrjedhjen e ujit.

Rubinetat duhet të sigurojnë rezistencë perfekte ndaj korrozionit, rezistencë ndaj agjentëve kimike, pamje sa më të mirë, mundësi të thjeshtë riparimi, jetëgjatësi dhe qëndrueshmëri ndaj goditjeve mekanike. Rubinetat duhet të përballojnë një presion 1,5 herë më tepër se vetë tubat e linjës. Ato duhet të përballojnë një presion minimal prej 10 atm.

Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e rubinetave në pajisjet hidrosanitare të bëhen sipas kërkesave teknike të supervizorit dhe të projektit.

Një model i rubinetës së duhur që do të përdoret sëbashku me çertifikatën e cilësisë, çertifikatën e origjinës, çertifikatën e testimit dhe të garancisë do ti jepet për shqyrtim Supervisorit për një aprovim para se të vendoset në objekt. Të dhënat mbi diametrin e jashtëm të rubinetit, modelin e tij, presionin, emrin e prodhuesit, standartit që i referohen, viti i prodhimit, etj duhet të jepen në katalogun përkatës që shoqëron mallin. Supervisorit mund të bëjë teste plotësuese për cilësinë e tyre si dhe presionin që durojnë pas instalimit (Testi i presionit bëhet me 1.5 herë të presionit të punës).

PUNIMET ELEKTRIKE

Përcjellsat dhe kabllot

Të gjithë përcjellsat dhe kabllot duhet të kenë çertifikatën e aprovimit të autoriteteve lokale përkatëse dhe çertifikatën e fabrikës. Përcjellsat duhet të jenë bakri të izoluar (veshur) me shtresë teke PVC për tu futur brenda tubave ose kanalëve. Të gjitha rastet kur kabllot përfundojnë në një panel shpërndarës ose paisje elektrike etj, duhet lënë një sasi kablli reserve (10-15cm) për të lejuar në të ardhmen zhveshjen e rilidhjen me terminalët pa shkaktuar tërheqje të tyre. Zhveshja e izolimit në kabllot e izoluar me gomë ose PVC duhet të kryhet duke përdorur vegël të përshtatshme për zhveshjen, dhe jo thikë.

Përcjellsat duhet të jenë me shtresën izoluese të ngjyrosur për identifikim. Blu-ja duhet të përdoret për përçuesit e neutrit, Jeshilja/e verdha duhet të përdoren për përçuesit e tokës dhe ngjyra e kuqe/jeshil/kafe ose e verdhë për përçuesit fazë. Të bëhet kujdes që ngjyrat e përcaktuara për fazat të mbeten të njëjtat për instalimin në të gjithë shtrirjen e tij.

Të gjithë kabllot duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të kenë vulën e prodhuesit ose prova të tjera të origjinës dhe kontraktuesi duhet të marrë çertifikatat e testeve të përhershme të prodhuesit kundrejt një urdhri të dhënë, n.q.s kërkohet nga inxhinieri.

Në një tub zakonisht futet një kabell i vetëm (ose një grup me 3 përcjellës), por nëse duam të rrisim numrin e tyre në kalimet vertikale, numri i kabllave që duhen instaluar në tuba duhet të jetë aq sa të lejojë futjen e lehtë pa dëme të kabllave dhe nuk duhet të zërë në asnjë rrethanë më shumë se 40% të hapësirës. Instalimi duhet të përputhet me KTZ.

Të gjitha kabllot duhet të kenë çertifikatën e aprovimit të autoriteteve lokale përkatëse dhe çertifikatën e fabrikës prodhuese.

Izolimi i kabllave duhet të durojë 600/1000 V tip-FG7(O)R.

Kabllot fleksibël duhet të kenë dejet të ngjyrosura për identifikim. Blu-ja duhet të përdoret për përçuesit e neutrit, Jeshilja/e verdha duhet të përdoren për përçuesit e tokës dhe ngjyra e kuqe/jeshil dhe e verdhë për përçuesit fazë. Të njëjtat ngjyra duhet të përdoren për lidhjet në të njëjtën fazë furnizimi për të gjithë instalimet.

Asnjë kabell me seksion më të vogël se 1.5 mm² për ndriçim dhe 2.5mm² për prizat s' duhet të përdoret me instalim vetëm nëse përmendet në veçanti. Përçuesit e tokës duhet të kenë një masë minimale të kërkuar nga rregullorja.

-Nuk duhet të mbajne më tepër se 80% të ngarkesës së tyre nominale korrigjuar në përputhje me kushtet e vendosjes

-Rënia e tensionit nga fillimi i rrjetit të T.U. deri tek konsumatori me i largët nuk duhet të kalojë 4%, si për ndriçimin edhe për fuqinë motorrike.

Tipet e kabllave e përcjellesave që do të përdoren janë:

-Kabell fleksibel multipolar,izolim gome etilenpropilenik,riveshur me PVC,tip FG7(O)R 0.6/1kV me percjelles bakri te ripjekur,qe nuk perhapin flake dhe qe nuk permbajne halogjene ne tymin e djegjes,rezja e ktheses 4-6 here diametrin,storcimi ne terheqje jo me teper se 5kg/mm².

-Percjellesfleksibel nje polar,prej bakri te ripjekur,izolim me rezine N07V-K, qe nuk perhapin flake, rezja e ktheses 4 here diametrin,storcimi ne terheqje jo me teper se 5kg/mm².

Kabllo e vendosur në kanalinat duhen fiksuar, në veçanti në kalimet vertikale dhe te pjerreta fiksime duhet te jene me te dendura dhe te pershtateshme per te mbajtur peshen e tyre.Kabllo vendosen ne distance midis tyre per te siguruar ftohjen e nevojshme.

Per vendosjet brenda tubacioneve,duhet te kemi nje montim dhe çmontim komod te kabllove.Ndalohet shtesa e kabllove e percjellesave brenda tubacioneve.Ata duhet te priten ne gjatesine e duhur per çdo rast.

Kanalet dhe aksesorët

Kabllo dhe percjellesit e instalimeve elektrike mund të bëhen në dy mënyra:

- Nën suva të futura në tuba PVC fleksibël
- Mbi suva në kanaleta prej lllamarine zinkato të përforcuar

Aksesorët e instalimeve nën suva janë:

• Tubat fleksibël PVC të dimensioneve të ndryshme në varësi të dimensionit dhe të numrit të percjellsave që do të futen në të.

- Kutitë shpërndarëse
- Kutitë për fiksimin e prizave ose të çelësave

Të gjitha këto vendosen para se të bëhet suvatimi.

Për kryerjen e instalimeve elektrike të futura nën suva duhet të ndiqet rradha e punës si më poshtë:

• Hapja e kanaleve në mur më dimension të tillë që të vendoset lirshëm tubi fleksibël dhe me thellësi të tillë që të mos dalë mbi nivelin e suvasë përfundimtare.

• Vendosen tubat fleksibël dhe kutitë prej PVC të cilët provizorisht fiksohen me allçi (më vonë mbyllen kanalet me llaç suvatimi)

• Pasi është kryer suvatimi, futen telat ose kabllo, me anë të udhëzuesit të tyre, të cilat duhet të hyjnë lirshëm dhe të lihet në të dy krahët një sasi e mjaftueshme për kryerjen e lidhjeve dhe montimeve.

Tubot rigjid duhet te jene te tipit termoplastik,vetshuarës,me çlirim shumë te ulet te halogjeneve,me :

-rezistence 150kg/dm ne 20°C

-rezistenca ndaj nxehtesise nga 20 ne +90°C

-Rigjiditeti dielektrikmbi 2000V ne 50Hz per 15'

-vetshuarja ne me pak se 30"

-padjegshmeria 850°C

-reaksioni ndaj zjarrit categoria I, sipas CSE

-ngjyra gri



Tubat fleksibël duhet të jenë sipas standarteve përkatëse të mëposhtme:

- Përputhja me standartet: CEI 23-32.
- Materiali PVC.
- Rezistenca e izolimit: 100 MΩ
- Shkalla IP:IP40
- Qëndrueshmëria ndaj goditjeve:IK08
- Temperatura e instaluar: -5/60 °C.

Kanalet dhe vendosja e tubave fleksibël PVC duhet të bëhet në distancë 0.4 m më poshtë nga niveli i tavanit, në vijë të drejtë horizontale dhe zbritjet për çelësa ose prizat të bëhen vertikale të drejta dhe jo me kënd ose në formë harku.



Tub fleksibel për instalime në beton dhe nën suva

Për instalimet në ambiente të jashtme brenda në masiv dheu ose betoni për linja kryesore furnizimi ose ndricim rrugor ose lulishte, trotuare duhet të përdoret tub PVC fleksibël, me dy veshje, seksioni i të cilit duhet të mundësojë me lehtësi kalimin e linjave kablore. Seksioni minimal i tubit të përdorur për këtë qëllim duhet të jetë D=60mm.



Tub flexibel me dopio veshje për instalime në ambiente të jashtme

Kutitë shpërndarëse

Kutitë shpërndarëse në varësi të sistemit që do të përdoret janë për nën suvatim ose mbi suvatim kështu që mënyra e fiksimit të tyre është ose me allçi ose me anë të vidave me upa.

Përmasat dhe format e kutive shpërndarëse variojnë sipas rastit dhe nevojës. E rëndësishme është që lidhja e percjellsave/kabllove brenda në kutitë shpërndarëse të realizohet me anë të klemeve bashkuese ose fundore.

Sistemi i kanalinave

Sistemi i kanalinave ashtu si sistemi i tubacioneve nën suva me tuba fleksibël duhet të plotësojë të gjitha kushtet teknike të instalimeve elektrike të përshkruara më sipër .

Sistemi i kanalinave përbëhet nga aksesorët e tij si:

- Kanalet me dimensione të ndryshme, në varësi të numrit të kabllove, që do të instalohen në të, gjatësia 2 m
- Këndorët (shërbejnë për formimin e këndeve në instalime) të cilat janë në varësi të kanalit që po shtrihet
- Devijuesit në formë T
- Kutitë shpërndarëse të dimensioneve të ndryshme



Kanalina metalike për magjistralet e linjave elektrike

Ndriçuesit

Ndriçuesit që do të përdoren në këtë projekt duhet të jenë prodhime të çertifikuara europiane, me llampë LED. Për ambientet e dhomave të mjekëve e korridoret , parashikohet ndriçues LED me përmasë 60*60cm, dhe fuqi 33-36W (funksion i produktorit), ndërsa për tualetet dhe për ndricimin e jashtëm tek fasada e hyrjes parashikohet ndriçues LED 26W IP 65. Pozicioni i ndriçuesve duhet të jetë si ai i treguar në projektin elektrik.

Instalimi i ndriçimit do kryhet duke përdorur kabllot FG7(O)R ose percjelles N07V-K, që kalojnë Brenda tubit fleksibël PVC, në përgjithësi të fshehura brenda suvasë së ndërtesës ose në kanaleta kur përdoret sistemi i kanalave.

Kabllot duhet të jenë në seksion minimal 1.5 mm², për ndricim dhe 2.5 mm², për prizat. Në të gjitha rastet duhet instaluar nje percjelles tokezimi i i ndare nga nuli i punes.

Ndriçuesit duhen fiksuar me siguri në tavanin ambienteve, të varur ose direkt në sipërfaqen e tavanit sipas llojit të ndriçuesit dhe të rekomandimit të dhëna nga prodhuesi.

Gjatë gjithë pjesëve të tavanaeve të varur, ku duhen instaluar ndriçuesit, lidhjet përfundimtare të çdo njerin duhen bërë me anë të një kablli fleksibël tre fijeësh, me cilësi të përshtatshme për të duruar nxehtësinë, nëpërmjet një rozete me fisha, lidhur me kutinë ose linjëzimin e kablllove.

Ndriçuesit montohen kur të kenë përfunduar të gjitha punimet e ndërtimit dhe të lysterjes.

Çdo ndriçues duhet të ketë një bllok konektori të fiksuar për të dalluar qartë kabllot hyrëse të fazës, nudit dhe tokës. Ky bllok konektori duhet të ketë përmasa të tilla që brenda tij të përfshihen kabllot me 2.5 mm² në çdo konektor.

Ndriçuesit e emergjencës dhe shenjat e daljes

Paketa e ndriçimit emergjent duhet montuar në ato vende, ku i ka parashikuar Inxhinieri projektues

elektrik. Paketa e emergjencës duhet të përfshijë mbushjen e plotë të baterisë me një ushqyes të aftë për të furnizuar me energji për një orë dhe tubin 18 WATT-ësh.



Ndriçues EXIT me varje vertikale nga tavan



Ndriçues emergjence EXIT per ambiente teknike

Kapaku i paketës duhet të ketë ngjyrë jeshile dhe të ketë shenjat përkatëse:

- Një njeri duke vrapuar,
- Shigjetën që tregon drejtimin e largimit,
- Fjalën dalje. të shkruara me ngjyrë të bardhë.

Çelësat e ndriçimit dhe prizat

Vendodhja e çelësave të ndriçimit tregohet sipas projektit dhe skicave të bëra nga inxhinieri elektrik projektues. Në përgjithësi çelësat e ndriçimit gjatë gjithë ndërtesës duhet të jenë të përshtatshme për montim të rrafshët (nën suvatim).

Çelësat duhet të jenë të parashikuar për kontrollin e rrejtës AC. Duhet të kenë një shkallë minimale prej 10 amper.

Prizat

Një sistem i kompletuar me njësi prizash duhet siguruar sipas projektit dhe skicave të bëra nga inxhinieri elektrik projektues.

Të gjitha prizat që do të montohen duhet të jenë të tipit me tokëzim.

Prizat të jenë të tipit që montohen nën suvatim.

Prizat i ndajmë sipas detyrës që do të kryejnë në:

- Priza tensioni njëfazore, ose trefazore

Gjithë prizat, elektrike duhet të jenë të tipit 16 amper 2P+T

Sistemi i tokëzimit

Elektrodat e tokës do të jenë me një profil L, të galvanizuar çeliku 50x50x5mm (ose me elektroda togëzimi të zingurara) të futura në një thellësi minimale prej 2 metrash. Numri i elektrodave të tokëzimit varet nga lloji i truallit dhe nga ajo që R_t (rezistenca e tokëzimit), e cila duhet të jetë më e vogël se 4Ω . Për këtë pas përfundimit të vendosjes së elektrodave duhet bërë matje me aparat të R_t dhe të mbahet një proces

verbal, i cili duhet t'i paraqitet Supervizorit. Në rast se R_t është më e madhe se 4Ω , atëherë duhet të shtohet numri i elektrodave deri sa të arrihet ajo e kërkuara.

Elektrodat vendosen në formë drejtkëndëshi, trekëndëshi apo katrore sipas numrit të tyre por gjithmonë në një largësi 1.50 m nga njëra tjetra. Elektrodat lidhen me njëra tjetrën me anë të një shiriti zingatoje $40\text{mm} \times 4\text{mm}$, me anë të saldimit ose me anë të vidave me dado shtrënguese. Pika e lidhjes së elektrodave duhet të jetë bërë me lidhje përfundimtare kundra ndryshkut. Nga pika e fundit, dilet me shirit zingatoje $40\text{mm} \times 4\text{mm}$ dhe futet në dliomën e transformatorit, në shinën e potencialeve, dhe prej aty në të gjitha pajisjet e dhomës së transformatorit, duke shtrirë një litar bakri tokëzimi me seksion min. 35mm^2 .

Nga paneli kryesor i TU shpërndarjes tokëzimi shpërndahet së bashku me kabllin/telat e fazave dhe të nolit, në të gjitha daljet e tensionit dhe duhet të jetë me dimension min. 2.5mm^2 .

Pjesët metalike të instalimit dhe pjesët e pajisjeve të tjera të lidhura me instalimin duhet të tokëzohen në mënyrë të pavarur nga nuli i shpërndarjes dhe nuli i transformatorit të shpërndarjes. Përcjellesi i vazhdimësisë të tokëzimit, duhet të instalohet në të gjithë qarqet dhe të ngjitet në pjesët metalike të ndriçuesve. Të gjitha pjesët metalike të pajisjeve duhet të lidhen me sistemin e tokëzimit.

Sistemi i mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike

Sistemi i mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike ndërtohet i pavarur nga sistemi i tokëzimit dhe duhet të plotësojë kushtet teknike të zbatimit sipas KTZ –së së Shqipërisë.

Vlera e rezistencës të këtij sistemi duhet të jetë më e vogël se 10Ω . Gjatë punës për këtë sistem (pasi të jenë vendosur elektrodat) kryhen matje të R dhe në rast se ajo është më e madhe se 10Ω , atëherë duhet rritur numri i elektrodave derisa të arrihet kjo vlerë. Matjet duhen përsëritur dy here: në tokë me lagështirë dhe me tokë të thatë.

Materialet që do të përdoren për këtë sistem (shiritat, elektrodat që do të futen në tokë, shigjeta, bulonat fiksues etj.) duhet të jenë të gjitha prej zingu ose hekur të galvanizuar.

Shiritat duhet të jenë me përmasa $40\text{mm} \times 4\text{mm}$ ose $30\text{mm} \times 3\text{mm}$, ose shufër me diametër minimalisht 10mm .

Elektrodat duhet të jenë me gjatësi 1.5m , si në rastet kur do të përdoret hekur në formë "L" ($50 \times 50 \times 4\text{mm}$) i galvanizuar, ashtu edhe kur do të përdoren elektroda zingu të prodhuara nga fabrika.

Shigjeta duhet të jetë edhe ajo prej zingatoje, psh. një tub zingatoje $\frac{3}{4}$ ", i cili bëhet me majë dhe ka gjatësi të tillë që të dalë minimalisht 0.6m mbi pikat më të larta të objektit.

Bulonat dhe dadot që do të përdoren për fiksimit të shiritit me elektrodën duhet të jenë minimalisht M 12.

Shpërndarja e fuqisë

Rrjeti shpërndarës i tensionit të ulët realizohet sipas projektit elektrik dhe duhet të plotësojë të gjitha kushtet e KTZ në Shqipëri. Shpërndarja e tensionit të ulët fillon që nga paneli TU i kabines së transformacionit, deri në çdo prizë, çelës dhe ndriçues. Shpërndarja e TU bëhet me anë të përcjellsave ose të kabllave.

Paneli kryesor i tensionit të ulët

Paneli kryesor i tensionit të ulët vendoset në ambjent të pershtatshëm në katin perdhe.

Ai duhet të jetë metalik, i lyer me bojë, që i reziston korozionit, si dhe të jetë i mbyllshëm me çelës. Përmasat e tij janë në varësi të pajisjeve elektrike që do të montohen, të cilat janë në varësi të ngarkesës së godinës.

Paneli kryesor i TU duhet të përmbajë :

- Matësin e energjisë elektrike 3 fazor (nje fazor)
- Automatin kryesor trefazor 400 V, amperazhi varet nga ngarkesa
- Automatet trefazor për çdo kat (sugjerohet që në çdo kat të shkohet me tre faza në mënyrë që të bëhet një shpërndarje sa më e mirë e ngarkesës dhe siguri më të madhe në furnizim)
- Ampermetra për çdo fazë me tregim në kapakun e tij
- Voltmetër me tre pozicione për të matur çdo fazë me tregim dhe komandim në kapakun e tij
- Sinjalizuesit e fazave me tregim në kapakun e tij
- Klemet e tokëzimit që lidhen me sistemin e tokëzimit

Montimi i tij dhe i përbërësve, duhet të bëhet nga specialisti elektrik sipas projektit. Të gjitha lidhjet e kablllove / telave brenda panelit, duhet të bëhet me anë të klemave bashkuese. Vetë paneli duke qenë metalik, duhet të lidhet me sistemin e tokëzimit.

Kuadrot shpërndarjes në kate

Këto kuadro, meqënëse do të vendosen në ambiente publike, duhet të jenë të mbyllshëm me çelës për arsye sigurie.

Elementët e domosdoshëm të këtyre paneleve janë:

- Automati kryesor 3 fazor manjetotermik dhe me mbrojtje diferenciale, amperazhi varet nga ngarkesa;
 - Sinjalizuesit e fazave (3 copë);
 - Automatët manjetotermik njëfazorë të fuqisë (prizave), të cilët në varësi të prizave që do të furnizohen kanë edhe amperazhin e tyre;
 - Automatët manjetotermik të ndriçimit, të cilët në varësi të ndriçuesave që do të furnizohen kanë edhe amperazhin e tyre;
- Parashikohet që sistemi i ndriçimit të jetë i ndarë nga ai i fuqisë.

Kompleti i gjeneratorit

Gjeneratori do të përdoret me kërkesën e investitorit. Montohet jashtë objektit pranë panelit kryesor të TU.

Gjeneratori duhet të jetë silencioz, me leshim automatik, prodhim me cilësi të lartë dhe të aprovohet nga porositësi para montimit.

Montimi dhe vënia në punë e tij për herë të parë, duhet bërë nga një personel i specializuar. Fuqia e gjeneratorit është në varësi të ngarkesës që ai do të mbajë dhe është llogaritur nga inxhinieri projektues elektrik.

Veçoritë teknike të mëposhtme për gjeneratorë duhet të merren në konsideratë:

Gjeneratorë më naftë”Stand by” 380V, 3fazor, 50Hz,

Me një depozitë lëndë djegëse për të siguruar punë të vazhdueshme jo më pak se 48 orë, rezistent ndaj kushteve të ambientit, pajisur me sistem shkarkimi(tymi) dhe antizhurmues.

Kuadri i kalimit automatik të ngarkesës

Kuadri i kalimit automatik në punë të gjeneratorit është një kuadër që zakonisht prodhohet nga e njëjta firmë që ka prodhuar gjeneratorin dhe montohet në afërsi të tij në të njëjtën dhomë.

Detyrat e tij janë që të bëjë kalimin automatik në punë të gjeneratorit në rast se ndërpritet furnizimi me energji nga rrjeti dhe anasjelltas, brenda një kohe të shkurtër nga 10 – 60 sekonda.

Celësi i transferimit automatik, përfshin 380v 3ph,50 Hz,250A me një sinjal për ndezjen e

gjeneratorit, ku voltazhi i linjës është nën limitet-25% deri 15% dhe frekuenca nën diapazonin 47- 53 Hz.

PUNIMET E RRJETIT

Kabli i rrjetit

Të gjithë kabllo duhet të kenë çertifikatën e aprovimit të autoriteteve lokale përkatëse dhe çertifikatën e fabrikës. Përcjellsat duhet të jenë bakri të izoluar (veshur) me shtresë PVC sipas standartit të mëposhtem për tu futur brenda tubave ose kanalave.

1.1 Kabell rrjet kompjuterik FTP-CAT6

Pass American FLUKE and ROHS test;

With CE, ISO and TLC Certification

1 Specification: 4P+Mylar+D+AL

Rated Temperature: 85°C

Unshielded twisted pairs:

Conductor: 26AWG or 24AWG Stranding or Solid Bare copper

Insulation: HD-PE

Drain Wire: 26AWG or 24AWG Stranding or Solid Tinned copper

Outer Shielded: AL-Mylar 100%(min) coverage

Unrip rope: optional

Jacket: PVC or LSNH

Impedance: $100 \pm 15\% \Omega$ at 1~250MHz

Reference : YD/T1019-2001,ISO/IEC11801,ANSI/TIA/EIA-568B,UL444

Print Legend: CM or CMR

APPLICATION: Mainly uses in the building correspondence synthesis wiring system the work area correspondence leading-out terminal and between the connection distribution frame wiring, as well as the housing synthesis wiring system's user correspondence leading-out terminal arrives at place of exile between coil's wiring

Patchcorda rrjeti FTP 1.0m cat.6

Kanalet dhe aksesorët

Kabllo e instalimeve te rrjetit kompjuterik,telefonik dhe video-CCTV mund të bëhen në dy mënyra:

- Nën suva të futura në tuba PVC fleksibël
- Mbi suva në kanaleta prej lllmarine zinkato të përforcuar

Aksesorët e instalimeve nën suva janë:

- Tubat fleksibël PVC të dimensioneve të ndryshme në varësi të dimensionit dhe të numrit të përcjellsave që do të futen në të.

- Kutitë shpërndarëse
- Kutitë për fiksimin e prizave ose të çelësave

Të gjitha këto vendosen para se të bëhet suvatimi.

Për kryerjen e instalimeve elektrike të futura nën suva duhet të ndiqet rradha e punës si më poshtë:

- Hapja e kanaleve në mur me dimension të tillë që të vendoset lirshëm tubi fleksibël dhe me thellësi të tillë që të mos dalë mbi nivelin e suvasë përfundimtare.

- Vendosen tubat fleksibël dhe kutitë prej PVC të cilët provizorisht fiksohen me allçi (me vonë mbyllen kanalet me llaç suvatimi)

- Pasi është kryer suvatimi, futen kabllo, me anë të udhëzuesit të tyre, të cilat duhet të hyjnë lirshëm dhe të lihet në të dy krahët një sasi e mjaftueshme për kryerjen e lidhjeve dhe montimeve.

Tubot rigjid duhet te jene te tipit termoplastik,vetshuarës,me çlirim shumë te ulet te halogjeneve,me :

-rezistence 150kg/dm ne 20°C

-rezistenca ndaj nxehtesise nga 20 ne +90°C


-Rigjediteti dielektrikmbi 2000V ne 50Hz per 15'

-vetshuarja ne me pak se 30"

-padjegshmeria 850°C

-reaksioni ndaj zjarrit categoria I, sipas CSE

-ngjyra gri



Tubat fleksibël duhet të jenë sipas standarteve përkatëse të mëposhtme:

- Përputhja me standartet: CEI 23-32.
- Materiali PVC.
- Rezistenca e izolimit: 100 MΩ
- Shkalla IP:IP40
- Qëndrueshmëria ndaj goditjeve:IK08
- Temperatura e instaluar: -5/60 °C.

Kanalet dhe vendosja e tubave fleksibël PVC duhet të bëhet në distancë 0.4 m më poshtë nga niveli i tavanit, në vijë të drejtë horizontale dhe zbritjet për çelësa ose prizat të bëhen vertikale të drejta dhe jo me kënd ose në formë harku.



Tub fleksibel për instalime në beton dhe nën suva

Për instalimet në ambiente të jashtme brenda në masiv dheu ose betoni për linja kryesore furnizimi ose ndricim rrugor ose lulishte, trotuare duhet të përdoret tub PVC fleksibël, me dopio veshje, seksioni i të cilit duhet të mundësojë me lehtësi kalimin e linjave kablore. Seksioni minimal i tubit të përdorur për këtë qëllim duhet të jetë D=60mm.



Tub flexibel me dopio veshje për instalime në ambiente të jashtme

Kutitë shpërndarëse

Kutitë shpërndarëse në varësi të sistemit që do të përdoret janë për nën suvatim ose mbi suvatim kështu që mënyra e fiksimit të tyre është ose me allçi ose me anë të vidave me upa.

Përmasat dhe format e kutive shpërndarëse variojnë sipas rastit dhe nevojës.

Sistemi i kanalrave

Sistemi i kanalrave ashtu si sistemi i tubacioneve nën suva me tuba fleksibël duhet të plotësojë të gjitha kushtet teknike të instalimeve elektrike të përshkruara më sipër .

Sistemi i kanalrave përbëhet nga aksesorët e tij si:

- Kanalet me dimensione të ndryshme, në varësi të numrit të kablllove, që do të instalohen në të, gjatësia 2 m
- Këndorët (shërbejnë për formimin e këndeve në instalime) të cilat janë në varësi të kanalit që po shtrihet
- Devijuesit në formë T
- Kutitë shpërndarëse të dimensioneve të ndryshme



Kanalina metalike për magjistralet e linjave elektrike

Rack qendror

Lartesia /	Tipi 16U
Gjeresia	19" (600mm)
Thellesia	>=500-600 mm
Dera e perparme	Me xham, me çeles
Dyert e pasme	Te mbylluara
Panelet anesore	Te çmontueshme/te levizshme

Grounding All cabinet components such as doors, side panels, roofs, etc. shall be bonded directly to the frame. Grounding points shall be provided on the cabinet's frame to externally bond each unit to the building ground.

Environmental RoHS compliant. The cabinet shall both protect the user from mechanical hazards and generally meet the requirements (stability, mechanical strength, aperture sizes, etc.) as defined in IEC 60950

Power feed Power bar 6-8ports, 220V-1000W, me Automat, Ndërprerës magneto-termik CDB6 1P, 10A, Llambë sinjalizimi me siguresa të brendshme 1.2w, 220V.

Patch panel RJ45-Cat6-24ports

- Leading 10G Series of Shielded Cat6a RJ45 Ports for maximum protection against EMI/RFI interference
- Accommodates 22-24AWG Solid, Shielded Cat6a cabling
- 1.75" x 19" rack mount panel design allows for higher port density, while taking up less rack space
- Industry Standard IDC 110 terminal blocks for fast and simple cable terminations
- Integral cable management and strain relief tray allow you to organize bigger O.D. CAT 6a bulk cables

Switch L2 me 8 ose 16 porta sipas kerkesave ne preventiv, POE

<p>KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE</p> <p>NDËRFAQET DHE KARAKTERISTIKAT HARDWARE</p> <p>Porta 10/100/1000Mbps RJ45</p> <p>(Auto Negocim /Auto MDI/MDIX) ≥ 8 ose 16, sipas preventivit</p>	<p>Të Ketë Mundësi për Upgrade Po</p> <p>QUALITY OF SERVICE</p> <p>Priority Queues Po</p> <p>Queue Scheduling SP, WRR</p> <p>VECORITË NË LAYER 2 DHE 3</p> <p>IGMP Snooping V1/V2/V3</p>
---	--

<p>Porta SFP Opsionale</p> <p>Porta Uplink (bakër/fiber)</p> <p>100/1000Mbps SFP Slots 2-4 / Combo Opsionale</p> <p>Porta Combo Opsionale</p> <p>Porta Console RJ-45/RS-232</p> <p>1</p> <p>Instalimi në Rack 19" Rack Mountable</p> <p>HYRJE "INPUT"</p> <p>Tensioni Nominal 100~240 V AC</p> <p>Frekuenca 50/60 Hz</p> <p>PERFORMANCA DHE FLEKSIBILITETI</p> <p>Switching Capacity ≥ 96 Gbps</p> <p>Throughput ≥ 70 Mpps</p> <p>Flash Memory 128 MB</p> <p>RAM 512 MB</p> <p>Jumbo Frame Opsionale</p> <p>Tabelë të Adresave MAC 16k</p> <p>Fan Opsionale</p> <p>STANDARDET</p> <p>IEEE 802.3 - 10BASE-T Po</p> <p>IEEE 802.3u - 100BASE-T Po</p> <p>IEEE 802.3ab - 1000BASE-T Po</p> <p>IEEE802.3z - 1000BASE-X Po</p> <p>IEEE 802.3ad - Agregim linku Po</p> <p>IEEE 802.3x - full duplex on 10BASE-T, 100BASE-TX, and 1000BASE-T ports Po</p> <p>IEEE 802.1d - Spanning Tree</p>	<p>Spanning Tree STP/RSTP/MSTP</p> <p>LLDP Po</p> <p>BPDU Filtering/Guard Po</p> <p>Detektim të Loopback Po</p> <p>802.3x Flow Control Po</p> <p>VLAN 4k, (Voice VLAN Opsional)</p> <p>Agregim të Linkeve 802.3ad LACP</p> <p>Adresimi IPv6 Po</p> <p>DHCP/BOOTP, DHCP Snooping, DHCP Option82 për klientët</p> <p>Po</p> <p>Dynamic ARP inspection (DAI) Po</p> <p>Limitim të Shpejtësisë Port/Flow</p> <p>Policy-Based Routing (PBR) Jo</p> <p>Routimi Jo</p> <p>SIGURIA</p> <p>Access Control List L2 - L4</p> <p>TCP/UDP Ports Po</p> <p>Protokollin DSCP Po</p> <p>Authentication TACACS+, RADIUS, IEEE 802.1X, Port/MAC,</p> <p>SSH v1/v2, SSLv2/v3/TLSv1</p> <p>Storm Control Broadcast, Multicast, Unicast</p> <p>MENAXHIMI</p> <p>Web-based GUI dhe CLI Po</p> <p>RS-232 Console / RJ-45 Console Po</p>
---	--

<p>Protocol Po</p> <p>IEEE 802.1s - multi STP Po</p> <p>IEEE 802.1w - RSTP Po</p> <p>IEEE 802.1q - VLAN Po</p> <p>IEEE 802.1x - Port-based Network Access</p> <p>Control Po</p> <p>IEEE 802.1p - QoS Classification Opsionale</p> <p>IEEE 802.3af - PoE Opsionale</p> <p>AKSHI Standardet Teknike për pajisjet elektronike për përdorim zyre 2019 40</p> <p>IEEE 802.3at - PoE Opsionale</p> <p>SISTEMI OPERATIV</p> <p>Të Jetë i Orientuar për Operacionet LAN Po</p>	<p>Telnet, SSH Po</p> <p>Monitorim të CPU Po</p> <p>SNTP Po</p> <p>Upgrade të Firmware TFTP ose ndërfaqes Web</p> <p>Ekran LED Opsionale</p> <p>SNMP v1/v2c/v3 Po</p> <p>SYSLOG Po</p> <p>Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty": 1 Vit</p>
--	--

Switch L2 me 24 porta sipas kerkesave ne preventiv, POE

<p>Switch L2 me 24 porta</p> <p>KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE NDËRFAQET DHE KARAKTERISTIKAT HARDWARE</p> <p>Porta 10/100/1000Mbps RJ45 (Auto Negocim /Auto MDI/MDIX) ≥ 24</p> <p>Porta SFP Opsionale</p> <p>Porta Uplink (baker/fiber) 100/1000Mbps SFP Slots 2-4 / Combo Opsionale</p> <p>Porta Combo Opsionale</p> <p>Porta Console RJ-45/RS-232 1 Instalimi në Rack 19" Rack Mountable</p> <p>HYRJE "INPUT" Tensioni Nominal 100~240 V AC</p> <p>Frekuenca 50/60 Hz</p> <p>PERFORMANCA DHE FLEKSIBILITETI</p> <p>Switching Capacity ≥ 96 Gbps</p> <p>Throughput ≥ 70 Mpps</p> <p>Flash Memory 128 MB</p> <p>RAM 512 MB</p> <p>Jumbo Frame</p>	<p>AKSHI Standardet Teknike për pajisjet elektronike për përdorim zyre 2019 40</p> <p>IEEE 802.3at - PoE Opsionale</p> <p>SISTEMI OPERATIV Të Jetë i Orientuar për Operacionet LAN Po</p> <p>Të Ketë Mundësi për Upgrade Po</p> <p>QUALITY OF SERVICE</p> <p>Priority Queues Po</p> <p>Queue Scheduling SP, WRR</p> <p>VECORITË NË LAYER 2 DHE 3</p> <p>IGMP Snooping V1/V2/V3</p> <p>Spanning Tree STP/RSTP/MSTP</p> <p>LLDP Po BPDU Filtering/Guard Po</p> <p>Detektim të Loopback Po</p> <p>802.3x Flow Control Po</p> <p>VLAN 4k, (Voice VLAN Opsional)</p> <p>Agregim të Linkeve 802.3ad</p> <p>LACP Adresimi IPv6 Po</p> <p>DHCP/BOOTP, DHCP Snooping, DHCP Option82 për klientët Po</p> <p>Dynamic ARP inspection (DAI)</p>
--	--

<p>Opsionale Tabelë të Adresave MAC 16k Fan Opsionale STANDARDET IEEE 802.3 - 10BASE-T Po IEEE 802.3u - 100BASE-T Po IEEE 802.3ab - 1000BASE-T Po IEEE802.3z - 1000BASE-X Po IEEE 802.3ad - Agregim linku Po IEEE 802.3x - full duplex on 10BASE-T, 100BASE-TX, and 1000BASE-T ports Po IEEE 802.1d - Spanning Tree Protocol Po IEEE 802.1s - multi STP Po IEEE 802.1w - RSTP Po IEEE 802.1q - VLAN Po IEEE 802.1x - Port-based Network Access Control Po IEEE 802.1p - QoS Classification Opsionale IEEE 802.3af - PoE Opsionale</p>	<p>Po Limitim të Shpejtësisë Port/Flow Policy-Based Routing (PBR) Jo Routimi Jo SIGURIA Access Control List L2 - L4 TCP/UDP Ports Po Protokollin DSCP Po Authentication TACACS+, RADIUS, IEEE 802.1X, Port/MAC, SSH v1/v2, SSLv2/v3/TLSv1 Storm Control Broadcast, Multicast, Unicast MENAXHIMI Web-based GUI dhe CLI Po RS-232 Console / RJ- 45 Console Po Telnet, SSH Po Monitorim të CPU Po SNMP Po Upgrade të Firmware TFTP ose ndërfaqes Web Ekran LED Opsionale SNMP v1/v2c/v3 Po SYSLOG Po Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty": 1 Vit</p>
---	--

Centrali telefonik:

- 2 Porta FXS
- 4 Porta FXO ports
- 2 Porta NIC Dual Gigabit Ethernet
- Porta Periferike USB, SD
- Protokolle G.711 A-law/U-law, G.722, G.723.1 5.3K/6.3K, G.726, G.729A/B,
- iLBC, GSM; T.38 Voice and Fax Codecs, H.264, H.263, H.263+ Video Codecs
- TCP/UDP/IP, RTP/RTCP, ICMP, ARP, DNS, DDNS, DHCP, NTP, TFTP, SSH,
- HTTP/HTTPS, PPPoE, SIP (RFC3261), STUN, SRTP, TLS Network Protocols
- Karakteristika te thirrjeve te Centralit Call park, call forward, call transfer, DND,
- ring/hunt group, paging/intercom among other features
- Minimum call capacity 100, Telefonata Simultane Deri ne 50
- Caller ID Bellcore/Telcordia, ETSI-FSK, ETSI-DTMF, SIN 227 – BT
- Ram min 512MB
- Hard Drive min 4GB Onboard Flash
- LCD Display
- Rack mount

5. Telefona VoIP (ne tavoline) duhet te kene:

Protokolle/Standartet

SIP RFC3261, TCP/IP/UDP, RTP/RTCP, HTTP/HTTPS, ARP/RARP, ICMP, DNS

(ARecord, SRV, NAPTR), DHCP, PPPoE, SSH, TFTP, NTP, STUN, SIMPLE,

LLDPMED, LDAP, TR-069, 802.1x, TLS, SRTP

Network Interfaces (Nderfaqja e rrjetit)

Dual switched auto-sensing 10/100 Mbps Ethernet ports, integrated PoE

Graphic Display (monitori): LCD display, min 2.98"

Karakteristika te tjera

3 XML programmable context sensitive soft keys, 5 (navigation, menu) keys. Different dedicated function keys for MUTE, HEADSET, TRANSFER, CONFERENCE, SEND and REDIAL, SPEAKERPHONE, VOLUME, PHONEBOOK, MESSAGE, HOLD, PAGE/INTERCOM, RECORD, HOME

Garancia e Sistemit VOIP eshte 1 vit.

Nga Operatori Ekonomik te behet lidhja e Centralit te Telefonise dhe programi i numrave te brendshem telefonik.

Sistemi Kamerave

7.1. NVR me 4 kanale me POE

- Hyrje Video/Audio Input IP dixhitale : 4 kanale
- Lidhje me kamera me distance te larget;
- HDMI dhe VGA simultan me dalje deri 1920×1080P rezolucion.
- Dedektim per rregjistrimet e diteve te festave kur nuk duhet;
- Live view I menjehershem (playback) ne disa kanale;
- Playback I zgjuar per te evituar sekuencat e panevojshme
- Organizimi i kuotave te HDD sipas group management; organizim per kapacitet te ndryshem per cdo kamer ;
- Te vete rregullohet (self-adaptive) ne rrjetet 10M/100M/1000M;
- Te gjej rrjetin automatikisht;
- Rezolucioni Rregjistrimit : 8MP
- Kapaciteti HDD te NVR: Max 10TB
- Rackmount

Kamera IP Vezhgimi

- Tipi Kameres: Indoor Cube, Indoor Dome
- Procesori i figurës (“image sensor”): Tipi sensorit: CMOS sensor Madhësia e sensorit: 1/X’, ku $X \leq 3$ • Rezolucioni i figurës: 4Mpx
- Ndjeshmëria minimale ndaj dritës e matur në 50 IRE: Color (me Ngjyra) B/W (Bardhe e Zi): Matur në 30 IRE
- Shutter Speed”: 1/25 to 1/10,000s
- Te Suportoje PIR (Passive Infrared Detection) IR 10-20m
- Tipi i lenteve Fikse • Reduktimi Zhurmes 3D
- IR Cut filter

- Sistemi Kabllimit per Kameran FTP shielded cat.6

Kamera IP Vezhgimi

- Tipi Kameses: outdoor, anti vandal
- Procesori i figurës (“image sensor”): Tipi sensorit: CMOS sensor Madhësia e sensorit: $1/X'$, ku $X \leq 3$ • Rezolucioni i figurës: min 4Mpx
- Ndjeshmëria minimale ndaj dritës e matur në 50 IRE: Color (me Ngjyra) B/W (Bardhe e Zi): Matur në 30 IRE
- Shutter Speed”: 1/25 to 1/10,000s
- Te Suportoje PIR (Passive Infrared Detection) IR 10-20m
- Tipi i lenteve Fikse • Reduktimi Zhurmes 3D
- IR Cut filter

Sistemi Kabllimit per Kameran FTP shielded cat 6

UPS 1000VA

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE

DALJE “OUTPUT”

Fuqia “Power”: 1000 VA

Faktori i Fuqisë “Power Factor”: ≥ 0.8

Forma e Valës “Wave Form”: Sinusoidale

Tensioni Nominal “Nominal Voltage”: 220-240 V AC

Frekuenca “Frequency”: 50 Hz +/- 5%

Rregullimi i Tensionit “Volt, Regul. (On

Battery)”: +/-10%

Prizat Dalëse “Output Connectors”: $\geq (4)$ IEC 320 C13 (nga bateria)

HYRJE “INPUT”

Tensioni nominal “Nominal Voltage”: 220 - 240 V AC

Frekuenca “Frequency”: 50 Hz

Dritarja e Tensionit “Voltage Window”: 170 - 270 V AC

Rregullim Automatik i Tensionit “AVR”: Po

Prizat Hyrëse “Input Connectors”: (1) IEC 320 C14

KOMUNIKIMI & MENAXHIMI

Programi i Fikjes "Shutdown Software": Po

Sinjalizim me LED "Led Indicators": Për të gjitha gjendjet

Sinjalizim me Zë "Audible Indicators": Për të gjitha gjendjet

Porta e Komunikimit "Interface": (1) DB9 Serial ose USB

Mbrojtja "Protection": Overload, Discharge, and Overcharge Protection

BATERITË

Koha e Transferimit "Transfer time": ≤ 4 ms

Koha e Funkionimit me Bateri "Back-Up

Time": ≥ 60 min. Me ngarkesë të plotë

Tipi i Baterive "Battery Type": 12 V DC 7 Ah Lead-Acid

AKSESORËT

Kabëll për Linjën Kryesore "Power Cord": (1) European IEC-C13

Kabëll për Lidhjen e PC "PC Power Cord": (2) IEC 320 C13 - IEC 320 C14

Kabëll për Komunikimin e të Dhënave

"Data Cable": (1) DB9 Serial - DB9 Serial ose USB - USB

GARANCIA

Periodha e Mbulimit të Garancisë

"Warranty": 2 Vjet

UPS 2000VA

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE

DALJE "OUTPUT"

Fuqia "Power": 2000 VA

Faktori i Fuqisë "Power Factor": ≥ 0.8

Forma e Valës "Wave Form": Sinusoidale

Tensioni Nominal "Nominal Voltage": 220-240 V AC

Frekuenca "Frequency": 50 Hz +/- 5%

Rregullimi i Tensionit "Volt, Regul. (On

Battery)": +/-10%

Prizat Dalëse "Output Connectors": $\geq (4)$ IEC 320 C13 (nga bateria)

HYRJE "INPUT"

Tensioni nominal "Nominal Voltage": 220 - 240 V AC

Frekuenca "Frequency": 50 Hz

Dritarja e Tensionit "Voltage Window": 170 - 270 V AC

Rregullim Automatik i Tensionit "AVR": Po

Prizat Hyrëse "Input Connectors": (1) IEC 320 C14

KOMUNIKIMI & MENAXHIMI

Programi i Fikjes "Shutdown Software": Po

Sinjalizim me LED "Led Indicators": Për të gjitha gjendjet

Sinjalizim me Zë "Audible Indicators": Për të gjitha gjendjet

Porta e Komunikimit "Interface": (1) DB9 Serial ose USB

Mbrojtja "Protection": Overload, Discharge, and Overcharge Protection

BATERITË

Koha e Transferimit "Transfer time": ≤ 4 ms

Koha e Funksionimit me Bateri "Back-Up

Time": ≥ 60 min. Me ngarkesë të plotë

Tipi i Baterive "Battery Type": 12 V DC 7 Ah Lead-Acid

AKSESORËT

Kabëll për Linjën Kryesore "Power Cord": (1) European IEC-C13

Kabëll për Lidhjen e PC "PC Power Cord": (2) IEC 320 C13 - IEC 320 C14

Kabëll për Komunikimin e të Dënuave

"Data Cable": (1) DB9 Serial - DB9 Serial ose USB - USB

GARANCIA

Periudha e Mbulimit të Garancisë

"Warranty": 2 Vjet

PUNIME MEKANIKE

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri

Bombulat fikëse

Sipas normave/standardeve bashkëkohore bombulat fikëse ndahen në klasa. Për shembull evropiane DIN EN 2 i ndan bombulat në këto klasa :

Klasa A:

Përdoret për zjarre që rezultojne nga materiale të forta si psh.: Dru, letër, tekstile, plastike, etj

Klasa B:

Përdoret për zjarre që rezultojne nga materiale të lëngshëm si psh.: benzinë, benzole, alkohol, vaj, etj.





Klasa C:

Përdoret për zjarre që rezultojnë nga materiale gazi si psh.: Metan, propan, etj.

Klasa D:

Përdoret për zjarre që rezultojnë nga materiale prej metali si psh.: alumin, magnesium, natrium, etj.

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura tipet e bombulave si dhe përdorimi i tyre varësisht nga materiali, i cili e shkakton zjarrin.

	Klasa:				
Bombula kundër zjarrit:					
Bombulë me pluhur	P _G	✓	✓	✓	
Bombulë me pluhur (pluhur kundër zjarrit nga metali)	P M				✓
Bombulë me pluhur (me Bombulë me dioksid karboni)	P pluhur special) K (CO ₂)		✓ ✓	✓	
Bombulë me ujë	W	✓			
Bombulë me shkumë	S	✓	✓		



Sasia e bombulave fikëse duhet të vendoset nga projektuesi i ndërtimit sipas kërkesave të normave/standardeve bashkëkohore dhe moderne (psh DIN EN 3). Ata duhet të mirëmbahen dhe të kontrollohen të paktën çdo dy vjet nga autoritetet e licënuara.

- Minimumin e nivelit të tingullit prej 5db (A) është i pranishëm në çdo klasë.
- Mosfeksionimi i një zileje të mos ndikojë në nivelin e përgjithshëm të sinjalizimit.

Fikse zjarri me pluhur.

Tip bombel (e levizshem). e ljer me të kuqe RAL 3000 e pajisur me një valvol që aktivizohet me dorezë pas heqjes së spinës së sigurisë, në valvol është lidhur një tub fleksibel, lança që shërben për të drejtuar rrugën e pluhurit. Klasa e zjarrit 55A-233BC, kapaciteti normal 12 kg,



pesha 17.6 kg. Diametri 190mm, lartësia 640 mm. Kaset + hidrant zjarri i brendshëm.

RAL 3000, valvol sigurie dhe moskthimi 2" (DN 50) materiali i grupit bronz.

Fikese zjarri me CO2

Fikëse me CO2 variojnë nga 2 deri në 5 kg.. Mbi flakën ky lloj shuarësi ushtron një efekt freskues dhe mbytës. Fikëset me CO2 janë specifik për fikjen e zjarreve të klasës B e C, por nuk janë të përshtatshëm për të fikur zjarre të klasës A sepse gazi që përmbajnë nuk arrin të fikë prushin që prodhon zjarri.



Fikese zjarri karrelato

Sipas normatives UNI5867 e lyer me ngjyre të kuqe me pluhur aposidik poliuretanic dhe rezistente ndaj gaditjeve, rrezeve UV, klimës dhe sferës gërryese industriale. Është e kompletuar me një valvol sigurie.



IMPIANTI MEKANIK NGROHJE/FTOHJE

Hyrje

Impianti i kondicionimit do të shërbejë për krijimin e mikroklimave nëpër ambientet e brendshme të objektit me parametrat përkatës të temperaturës, lagështisë së ajrit, kontrollin e presioneve të ambienteve, kontrollin e fluksit të qarkullimit të tij dhe sigurimin e pastërtisë së ajrit sipas kushteve specifike të çdo ambienti. Fleksibiliteti i impianteve dhe fasitlitet në furnizim, mirëmbajtje, administrim etj. Janë faktorë determinantë që në kompleks përcaktojnë për zgjedhjet e tipologjisë së impiantit të kondicionimit për secilin ambient në veçanti dhe të objektit.

Ambientet dhe strukturat arkitektonik është e ndryshme në funksion të dimensionimit të tyre dhe lokalizimit në projekt. Konfigurimi është i kompozuar në katër zona të ndryshme nga pikëpamja e konstruksionit, funksionalitetit dhe pajisjeve të instaluara:

- Dhoma për vizita;
- Dhoma shërbimi (infirmieri, ekonomiste);
- Korridoret dhe ambiente ndihmëse;
- Banjo.

Impianti me zgjerim direkt – gaz

Sistemi i gazit shërben për furnizimin e terminaleve të brendshme splitet individuale të cilat përballojnë ngarkesat termike të humbjeve në ambient dhe furnizohen me fluid (në gjendje të gaztë/lëngeët) nga sistemi i kompresorit të jashtëm individual për çdo pajisje split. Gazi frigoriferik R410A, është gaz ekologjik jo i dëmshëm për ambientin, furnizohet nga kompresorët nëpër njësitë e brendshme në sasinë e duhur në raport me kerkeseën. Pra aq sa të jetë kërkesa nga konsumatori për ngrohje apo ftohje, aq sasi gazi do të dërgohet për shkëmbimin termik, për të arritur nivelet e komfortit dhe të temperaturës së dëshiruar.

Njësite e jashtme

Njësitë e jashtme do të jenë të tipit monoblok, të paramontuara në fabrikë dhe të gatëshme për lidhjen me rrjetin e tubacioneve. Konstruksioni i tyre do të jetë prej llmarine çeliku të galvanizuar, të lyer me rezinë të pjekur, për garantimin e një rezistence të mirë UV.

Ato duhet të garantojnë funksionimin në ngrohje në kushte të temperaturës së jashtme deri -5°C (wet bulb) dhe në ftohje deri në temperatura të jashtme +43°C (dry bulb). Pajisjet e jashtme duhet të përfshijnë një kompresor të tipit high-pressure spiral, një ose disa këmbyes ajri të

pajisur me qark sub-cooling, valvolat elektronike të zgjerimit të mbrojtura në të dy anët me dy filtra, një valvol 4 rrugëshe, rezervuarin e likuidit dhe një set valvolash manually-operated në hyrje të tubacioneve, etj.

Lubrifikimi duhet të kryhet si rezultat i diferencës ndërmjet presioneve në hyrje dhe dalje, pa qenë nevoja e përdorimit të një pompe.

Të gjithë kompresorët duhet të jenë të montuar në mbështetëse anti-vibrante. Ato do të jenë të parangarkuara si me polivinil edhe me vaj, të jenë elektrikisht të mbrojtura me kontrollin e fazeve, sensor të presionit HP, rele, sensor të temperaturës së jashtme, etj.

Modulet e rregullatorëve elektronikë të integruar në këto njësi duhet të sigurojnë një kontroll linear të vazhduar të kompresorit dhe shpejtesisë së ventilatorit/ventilatorëve të jashtëm.

Ventilatorët do të jenë të tipit helikoidal dhe do të largojnë ajrin horizontalisht. Çdo modul do të ketë:

- një motor DC, vazhdimisht të lubrifikuar dhe të mbrojtur nga infiltrimet e ujit;
- ventilator me efikasitet të lartë, dinamikisht të balancuar.

Njësitet e brendëshme

Njësitet e brendëshme do të jenë të tipit "split mural" me dhënje ajri ballore dhe thithje nga sipër dhe do të instalohen në brendësi të ambienteve që do të kondicionohen. Trupi i njësisë do të jetë prej polystireni. Kondensati do të largohet nëpërmjet vaskesteës dhe tubit të shkarkimit të kondensatit me rrjedhje të lirë.

Të gjitha punimet e mirëmbajtjes do të kryhen nga poshtë njësisë, përjashtuar kontrollin e rrjedhjeve, për të cilin është e nevojshme të sigurohet një hapje kontrolli në afërsi të lidhjeve me tubacionet e fluidit ftohës. Çdo njesi e brendëshme do të jetë e pajisur me elementët e mëposhtëm: një këmbyses nxehtësie me shumë kalime, një valvol elektronike zgjerimi me diapazon të rregullueshëm të mbrojtur nga dy filtra, një ventilator i brendshëm i aftë të realizojë të pakten 3 shpejtësi pune, dy sensorë të kontrollit të fluidit (likuid dhe gaz), dy sensorë ajri (dërgim dhe rriqarkullim), një filtër lehtësisht i heqshëm, i lashëm, për ajër të kondicionuar.

Sistemi i shpërndarjes së gazit dhe aksesorët përkatës

- Tubot e bakrit për sistemin me zgjerim direkt

Tubot e bakrit Cu për agjentë ftohës R410A janë të destinuara për përdorim kondicionimi dhe do të furnizohen së bashku me pajisjet, ndërsa rakorderitë do të jenë prej bronzi. Lidhjet do të realizohen me saldimit ose me shtrëngim sipas standardi UNI EN 378. Tubat duhet të izolojnë me një material të posaçëm për të mos lejuar humbjet e nxehtësisë apo fenomenin e kondensimit.

- Tubot e kondensimit të terminaleve

Tubot e kondensimit do të jenë tubo polipropileni PP me këto karakteristika:

- Densiteti i PP:	0,9 g/cm ³
- Temperatura e saldimit	146 °C
- Përcjellshmëria termike në 20 gradë	0,23 W/mK
- Koeficienti i zgjerimit linear	1,5 x 0,0001 K
- Elasticiteti në 20 gradë	670 N/mm ²
- Rezistenca në rrjedhje në 20 gradë	22 N/mm ²
- Rezistenca në shkatërim në 20 gradë	35 N/mm ²

- Niveli i zhurmave

Nivelet e zhurmave maksimale të lejuara brenda ambienteve janë përcaktuar nga norma UNI 8199 dhe janë 35 dB(A)

Rregullimi

Njësitet e brendëshme do të komandohen nga kontrollorë në distancë të tipit WIRED REMOTE CONTROL. Çdo kontrollor duhet të mundësojë përdoruesin të zgjedhë dhe të shoh parametrat e mëposhtëm:

- ndezjen dhe fikjen e pajisjes;

- temperaturën e kërkuar (në diapazonin 7°C/30°C);
- temperaturën e ambjentit;
- shpejtësinë e ventilatorit (Hi/Me/Lo).

Kontrollori në distancë duhet të bëjë të mundur zgjedhjen e mënyrës së operimit (5 mënyra ndërmjet të cilave edhe ngrohje/ftohje automatike), mbrojtje kundër ngrirjes, etj. Nëpërmjet një programimi të thjeshtë, kontrolli në distancë duhet të mundësojë ndërmjet të tjerash mundësinë e vrojtimit të parametrave të punës (temperaturën e kërkuar, mënyrën e operimit, shpejtësinë e ventilatorit dhe të gjithë funksionet dhe parametrat e tjera të nevojshëm për mirëmbajtjen (kodet e gabimeve, autodiagnostikën, etj.)

Grupi i punes

Ing. Laureta SHARRA

Ing. Altin SERANAJ

Ing. Andrin KËRPACI

Ing. Lindita DHAMO

Ing. Olimpion SHURDI

Ing. Ilo BODI

Ark. Ilgen ÇELA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____/____/ 2019

RELACION TEKNIK

**Objekti : "RISHIKIMI I PROJEKT PREVENTIVAVE EKZISTUESE QË JANË
HARTUAR PËR QENDRA SHËNDETËSORE & AMBULANCA, GJATË
VITIT 2015", LOTI 1**

POROSITËS: MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

KONTRAKTOR: UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

EMËRTIMI I OBJEKTIT: QENDRA SHENDETSORE POLIÇAN.

RAJONI: VLORE

Adresa: Sheshi "NënëTereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al



PËRMBAJTIA

1	Qëllimi i relacionit teknik	2
2	Grupi i punes	2
3	Adresa e objekteve	2
4	Përshkrim i përgjithshëm i objektit dhe evidentimi i problematikave	2
5	Pershkrimi i punimeve ndertimore te rikonstruksionit	3
6	Sistemi i furnizimit me ujë	4
7	Sistemi i kanalizimeve	5
8	Impianti i mbrojtjes nga zjarri	8
9	Instalimet elektrike	10
10	Instalimet rrjeti kompjuterik, telefonia dhe video-cctv	17
11	Impianti mekanik ngrohje/ftohje	27



1. QËLLIMI I RELACIONIT TEKNIK

Ky relacion teknik, realizohet për objektin: “Rishikim projekt-preventivave I 54 qendrave shëndetësore”; me porositës Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe kontraktues Universiteti Politeknik i Tiranës, mbështetur në VKM Nr. 188, datë 13.03.2019 “Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre”.

2. GRUPI I PUNËS

ING. LAURETA SHARRA	–	PREVENTIVUES
ING. ALTI SERANAJ	–	ING. KONSTRUKTOR
ING. ILO BODI	–	ING. MEKANIK
ING. LINDITA DHAMO	–	ING. ELEKTRIK
ARK. ILGEN ÇELA	–	ARKIEKTE
ING. OLIMPION SHURDI	–	ING. ELEKTRONIK

3. ADRESA E OBJEKTEVE

Qendra shëndetësore Polican ndodhen ne, Gjirokaster.

4. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I OBJEKTIT DHE EVIDENTIMI I PROBLEMATIKAVE

Ky objekt është godinë 2 katëshe, i vendosur në një terren me pjerresi te lehte qe nuk mban lageshti. Konfiguracioni i tij është i rregullt si në plan, edhe në lartësi. Godina është ndërtuar para viteve 1990.

Kontruksioni i ndërtesës është me mur mbajtës guri, e mbuluar me çati.

Objekti eshte i rrethuar me mur. Rreth objektit nuk ka nje trotuar. Objekti ka sistem kanalizimi por nuk dallohen pusetat.

Objekti nuk ka dalje direkte ne rrugen kryesore te zones. Poe ndodhet shume afer saj.

Objekti eshte i shtruar me pllaka dhe i suvatuar. Keto jane realizuar para viteve 1990. Tavani i katit te dyte eshte pergjithesisht i demtuar dhe me lageshti. Dyert jane druri te vjetra te demtuara, dritaret jane durale pa davancale.



Sistemi elektrik dhe hidraulik eshte i vjeter i amortizuar.

Ka proleme me lageshtine e cila vjen nga tre burime. Nga poshte pershkak te filtrimeve dhe kapilaritetit te themeleve qe verehet edhe ne lageshtine ne xokolature. Nga sistemi i amortizuar hidraulik i cili ka demtuar suvatime ne nyjet hidrosanitare dhe ne lavamanet ne dhomat e mjekeve. Nga catia e cila kryesisht ka demtuar tavanet e varur.

Nyjet hidrosanitare jane jashte funksionit dhe lidhja me ujesjellesin eshte nderprere.

Objketi nuk ka sistem monitorimi

Objketi nuk ka mbrojtje nga zjarri.

Objketi nuk ka sistem ngrohjeje dhe ai realizohet nga vete personeli me mjete rrethanore duke perdorur kryesisht energjine elektrike. Ne te shumten e rasteve ambientet jane te ftohta per shkak te rrjetit te amortizuar elektrik.

Ne objekt nuk ka rampe per invalidet.

Kati i pare i objektit eshte i gjithi jashte funksionit.

Vajtja ne objekt realizohet me rrugë automobilistike e pa shtruar. Hyrja ne objekt realizohet me kembe. Territori perreth objektit është i sistemuar.

5. PERSHKRIMI I PUNIMEVE NDERTIMORE TE RIKONSTRUKSIONIT

Grupi i punës, nga kqyrja në vend e objektit, si dhe duke iu referuar detyrës së projektimit të dhënë nga investitori, është i mendimit se:

Objekti 1 katësh, i cili shërben si qendër shënetësore, eshte i shfrytezueshem dhe ka nevojë per rikonstrukcion.

Qellimi kryesor eshte te realizohet rikonstrukcioni per te perfituar nje infrastrukture dhe ambiente shërbimi cilesore e pershtatshme per te gjithë grup moshat dhe per te gjithë shërbimet qe eshte e destinuar te perballoje.

Eliminimi i problemeve te lageshtise do te behet duke marre ne konsiderate faktoret te cilet e shkaktojne ate.

Catia do te rikonstruktohet duke marre ne konsiderate perdorimin e 50% te materialit te perdorshem dhe duke ruajtur te njejtin konfiguracion dhe strukture ndertimi si struktura ekzistuese.

Tavani i varur do te hiqet dhe do te zevendesohet me nje tavan te ri i cili do te realizohet me gips si teknologji e kohes, e paster, relativisht e lehte per tu realizuar, per tu rikonstruktuar ne rast nevojë dhe lehtesisht i zevendesueshem.

Instalimet ne tavan do te mbeshteten kryesisht ne elementet mbajtes te catise dhe vetem daljet do te kene ne tavan sic jane pergjithesisht ndricuesit.

Do te realizohet suvatime te reja duhe i hequr ato ekzistuese duke eliminuar demtimet qe mund te kete dhe qe mund te pesoje per shkak te realizimit te instalimeve te reja.

Do te hiqen pllakat ekzistuese per shkak te demtimeve qe mund te kene ose te pesojne per shkak te realizimit te instalimeve te reja dhe do te realizohet shtrese e re me pllaka. Plintusat



do të jenë të njëjta me pllakat madje do të realizohen duke prerë pllakat e njëjta me ato që do të permbajë shtresa

Sipërfaqja e dyshemese në kontakt me token do të hidroizolohet me dy duar bitum për të shmangur lageshtinë e cila vjen nga kontakti i dyshemese me token.

Në të gjithë perimetrin në distancë të precaktuar në projektin arkitektonik do të vendoset një kornizë derrase me gjerësi 10 cm, kryesisht në lartësinë e kontaktit të dorës me muret për të shmangur kontaktin e dretpërdrejtë me muret.

Në zonën e lavamanëve në dhomat e mjekëve është planifikuar veshja me pllakë nga dyshemeja deri 50 cm mbi lavaman për të shmangur lagjen e mureve edhe nën lavaman.

Uc do të hidroizolohet me një dorë letër katrama. Muret janë planifikuar të vishen me pllakë duke filluar nga dyshemeja deri në lartësinë 2,2 m e lart.

Dyert do të realizohen duralumini me mbushje, dhe në zonën e dhene sipas skicës së arkitektures do të kenjë një hapje e mbushur me xham gjysem transparent ose të patëjdukshëm.

Dyert e jashtme do të realizohen duralumini me dopioxham.

Edhe dritaret do të realizohen dopioxham për shmangjen e tejçimit të nxehtësisë.

Suvatimet e jashtme aty ku është e nevojshme vetëm do të riparohen dhe e gjithë sipërfaqja e jashtme do të vishet me sistemin kapote. Janë parashikuar dy lloje sisteme kapote, një për xokolaturen, i cili përmban elemente me shumë rezistues dhe mbrojtës ndaj lageshtisë së sistemit i përdorur në mure, për të mos u demtuar nga faktorët që shkaktojnë demtimin e tij dhe që kryesisht e kanë burimin nga toka dhe sistemi i dytë do të jetë ai i përdorur në muret nga xokolatura deri në nivelin e mbulimit të objektit.

Për shkakun e lageshtisë e cila vjen si rezultat i kapilaritetit të themeleve dhe xokolatures është përdorur injektim në lartësinë nga 50 deri në 80 cm në zonat të cilat e shfaqin këtë problem.

Rikonstruksioni konsiston gjithashtu në realizimin e sistemeve të reja të rrjeteve të ndryshëm inxhinierike (hidraulike, elektrike, shkarkimet e ujerave të zeza, rrjeti kompjuterik, telefonik dhe i kamerave, sistemi i mbrojtjes nga zjarri dhe sistemi i ngrohjes). Në realizimin e suvatimeve të reja,

6. SISTEMI I FURNIZIMIT ME UJË

Sistemi i furnizimit me ujë në objektin e mësipërm, destinohet për marrjen e ujit nga rrjeti, dhe nëpërmjet tubacioneve të mirëdimensionuar, si dhe të dispozitivave dhe aksesoreve të ndryshëm, bën të mundur ndërprerjen e fluksit, rregullimin dhe dërgimin e tij tek përdoruesi. Rrjeti i furnizimit me ujë është projektuar me kujdes për të realizuar një furnizim të rregullt për vlerat e dëshiruara të prurjes, presionit, dhe vlerat e lejuara të zhurmave dhe vibracioneve si dhe për të siguruar kushte higjienike normale.

Struktura e sistemit të furnizimit me ujë përbëhet nga këta komponentë:



Lidhja me rrjetin e jashtëm (rrugor) të ujës-jellësit

- Tubi i hyrjes do të jetë Plastik PE 100 me $\varnothing = 40 \div 50$ mm dhe pika e lidhjes do të përcaktohet nga Ndërmarrja e Ujës-jellës-Kanalizimeve;
- Në pikën e lidhjes do të ndërtohet një pusëtë qëndrore kontrolli me lartësi sa thellësia e vendosjes së tubit rrugor;
- Brenda pusëtës do të vendosen sipas rradhës një saraçineskë me sferë, $\varnothing = 50$ mm, një kontaktor, $\varnothing = 50$ mm dhe një kundërvalvol $\varnothing = 50$ mm.
- Furnizimi magjstral do të realizohet me tubacion $\varnothing = 50$ mm.

Sistemi i shpërndarjes në godinë

Është përzgjedhur sistemi klasik i shpërndarjes së ujit nga poshtë-lart, duke filluar nga kuota e bodrumit.

Diametri i kollonave se furnizimit me uje do te jete $\varnothing=40$ mm

Tubacionet e kollonave që ngrihen vertikalisht, do të jenë plastike me $\varnothing = 40$ mm (PP-R PN20, konform normave DIN 8077 – 8078A1 dhe standarteve DVGW E534). Kollonat do të vendosen në vendin e caktuar sipas projektit arkitektonik dhe do të vishen me izolant PE për mbrojtjen nga ngricat.

Sistemi i shpërndarjes do të realizohet me tubo plastike me $\varnothing = 25$ mm (25×4.2 mm PP-R PN20, konform normave DIN 8077 – 8078A1 dhe standarteve DVGW E534).

Tubacionet në brendësi të apartamenteve do të jenë me $\varnothing = 20$ mm (20×3.4 mm PP-R PN20, konform normave DIN 8077 – 8078A1 dhe standarteve DVGW E534), të vendosur sipas rastit në mur ose në dysheme dhe do të mbulohen me llaç çimento 1 : 2 dhe nga pllakat e shtrimit.

Përpara se të mbyllen kanalet, do të bëhet prova hidraulike me presion 6 bar; nuk duhet të konstatohet rënie presioni për një kohë prej 8 orësh.

Uji i ngrohtë do të merret nga bojlerat elektrikë me kapacitet 80 litra .

Kuotat e furnizimit me ujë për aparatet hidrosanitare do të realizohen në varësi të secilit aparat dhe sipas përcaktimeve të bëra në projekt.

7. SISTEMI I KANALIZIMEVE

Sistemi në fjalë është i destinuar për shkarkimet e ujrave të banjave dhe lavamaneve.

Sistemi ka në përbërje të gjithë aparatet sanitare, rakorderitë dhe rrjetin e brendshëm. Dimensionimi si dhe kuotat përkatëse të montimit të tubacioneve të shkarkimit janë dhënë në vizatimet përkatëse.



Shkarkimet në brendësi të godinës

Tubat që do të përdoren në shkarkimet e ujrave të përdorur, si dhe rakorderitë përkatëse do të jenë të çertifikuara sipas DIN EN 1451. Materiali i tyre do të jetë polipropilen i termostabilizuar në temperatura të larta. Ngjyra e këtyre tubacioneve është gri dhe do të livrohen në të gjitha gjatësitë e prodhuara.

Konstruktivisht, lidhja e tubacioneve do të jetë elastike në sajë të pjesëve fundore të tyre, lidhje të cilat realizohen në formën e xhuntove me gotë dhe guarnicioneve elastike në brendësi të tyre. Lidhjet realizohen me kujdesin e duhur duke pastruar guarnicionet, sipërfaqen e brendshme të gotës, si dhe ekstremitetet e zmusove të tubit të cilat mund edhe të lubrifikohen.

Në rastet kur tubat do të mbulohen me llaç direkt dhe pa interkapet, tubat duhet të vishen me karton të ondular, lesh mineral ose lesh xhami.

Tubat duhen izoluar edhe nga ana akustike, në mënyrë që sasia e zhurmës të shkaktuara nga shkarkimet, të mos e kalojë limitin 30 dB. Për këtë, muret e brendshëm të puseve duhet të vishen me suva me trashësi minimale 2 cm, e cila vendoset mbi një rrjetë teli. Në këtë rast, nuk duhet të formohen ura zanore midis tubave dhe suporteve të suvasë.

Kushtet teknike të montimit

1. Fiksimi i tubave të shkarkimit realizohet me anën e fashetave metalike me sipërfaqe të brendshme të gomuar, të cilat fiksohen me anën e vidave me upa plastikë.

Fashetat janë të dy llojeve:

- Fasheta fikse të cilat vendosen poshtë gotës së secilit tub për të evituar rrëshqitjen poshtë të pjesës së tubit. Në të njëjtën mënyrë fiksohen rakordet ose grupet e rakorderive.
 - Fasheta të rrëshqitëshme në të cila tubi mund të rrëshqasë dhe të zhvendoset në mënyrë aksiale, si pasojë e bymimeve, lëkundjeve sizmike, etj.
2. Devijimet e kollonave vertikale nuk do të jenë më shumë se 1 m dhe do të realizohen me brryla 45 °.
 3. Kthesat në këmbët e kollonave do të realizohen me dy brryla 45 ° dhe me tronket me gjatësi jo më të vogël se dyfishi i diametrit të jashtëm të kollonës.
 4. Kollonat në dalje mbi tarracë duhet të kenë një lartësi 30 cm mbi sipërfaqen e tarracës, në rastin kur distanca nga paretet e mundshëm është jo më e vogël se 2 m, dhe 10 cm mbi kuotën e dritares (në se ka një të tillë).
 5. Në derivacionet horizontale, gjatësia maksimale nuk duhet t'i kalojë 4 m dhe lidhjet e tyre me kollonat duhet të realizohen me braga (87 – 88.5 °).



6. Për të bërë të mundur pastrimin e gjithë rrjetit të shkarkimit, ai duhet të pajiset me pika kontrolli (shërbimi) të vendosura në hapësira të mjaftueshme për të punuar me pajisjet e pastrimit. Për këtë, në pjesën vertikale të këmbës së secilës kollonë, duhet të vendoset një bragë me kapak të filetuar hermetik. E njëjta gjë duhet parashikuar edhe për tubat e daljes horizontale para daljes së tyre nga ndërtesa. Në përgjithësi, kriteri që duhet zbatuar është një pikë kontrolli çdo 15 m për tuba me $d = 100$ mm, dhe çdo 30 m për tuba me $d > 100$ mm.
7. Vendosja e rrjetit të jashtëm të tubave në terren do të bëhet siç është treguar në vizatimin përkatës.

Dimensionimi i tubave të shkarkimit dhe kolektorëve

Dimensionimi i tubave të shkarkimit do të bëhet në bazë të prurjeve në periudhën e përdorimit maksimal të pajisjeve. Në këtë rast do të merret në konsideratë prurja totale nominale që del nga të gjitha pikat e shkarkimit, nga ku përcaktohen prurjet llogaritëse. Në bazë të këtyre prurjeve, bëhet përcaktimi i diametrave të tubacioneve.

Përsa u përket shkarkimeve të aparateve hidrosanitare në banja dhe kuzhina, në tabelën e mëposhtme jepen në mënyrë orientuese, diametrat dhe pjerrësitë e tubave përkatës:

Lloji i aparatit ose i tubit	Diametri i tubacionit (mm)	Pjerrësia	
		Normale	Minimale
Lavaman	50	0.035	0.025
Vazo	100	0.020	0.012
Dush	50	0.030	0.020
Vaskë	50	0.030	0.020
Bide	50	0.030	0.020
Lavapjata	50	0.030	0.020
Lavatriçe	50	0.030	0.020
Lavastovilje	50	0.030	0.020
Kollonë shkarkimi (banjo)	110	-	-
Kollonë shkarkimi (kuzhinat)	63	-	-
Piletë dysHEMEJE	40	0.035	0.025
Tub derdhjeje	140	0.020	0.012
Tub rrugor	200	0.005	0.005
Kollonë ventilimi (banjot)	160	-	-


Kolektimi i të gjitha prurjeve shkarkuese të kollonave do të bëhet në tubin e daljes, i cili përfundon në pusetën përkatëse. Për këtë llogaritet prurja totale që derdhet në tubin e daljes dhe me anën e tabelave përcaktohet prurja llogaritëse dhe diametri përkatës.





8. IMPIANTI I MBROJTJES NGA ZJARRI


Klasifikimi i klasave të zjarrit

Për të përdorur agjente shuarës të përshtatshëm gjatë procesit të mbrojtjes nga zjarri, në funksion të materialeve që mund të marrin flakë, duhet të merren parasysh në konsideratë klasat e zjarrit. Në bazë të normave/standarteve bashkëkohore, pajisjet shuarëse të zjarrit janë klasifikuar në pesë klasa. Standarti evropian DIN EN2 për këta shuarsa dallon klasat e mëposhtme:

Klasa  Përdoret për zjarre që e kanë origjinën prej materialeve të ngurtë sikurse dërrasë, letër, plastik, tekstile, etj.

Klasa  Përdoret për zjarre që e kanë origjinën prej materialeve të lëngshëm sikurse benzenë, benzole, naftë, alkol, vajra etj.

Klasa  Përdoret për zjarre që e kanë origjinën prej materialeve të gazta sikurse metan, propan, butan GPL etj.

Klasa  Përdoret për zjarre që e kanë origjinën prej materialeve metalike sikurse alumin, magnesium, sodium, etc.

Klasa  Përdoret për pajisje elektrike që janë nën tension.

Në të gjitha ambjentet e qendrave shëndetësore shkalla e rrezikut ndaj zjarrit është e njëjtë; nivel i ulët. Edhe kategoria e zjarreve të hamendesuara është po ashtu e njëjte, pasi kudo në këto ambjente zjarret do të jenë kryesisht të klasës "A" dhe të klasës "E" (kategoritë materiale të ngurtë të djegeshme dhe instalime dhe pajisje elektrike). Në tërësi, duke marrë në konsideratë edhe karakteristikat e ndërtesës si dhe destinacionin e saj, janë përdorur substanca shuarëse si më poshtë:

- hidrante dhe fikës portabël me pluhur;
- fikës portabël me anidrid karbonik në ambjentet e veçanta të shërbimit (ambjentin elektrik).

Hidrانتët dhe fikset të lëvizshme të zjarrit

Impiantet e shuarjes së zjarrit ndahen në :

- a) impiant të palëvizëshme të shuarjes së zjarrit në të cilën bëjnë pjesë:



- Hidrante në brendësi të godinës (aplikohen në korridore, zyra, salla etj.)
- Sprinklerat (aplikohen në pozicionet më të përshtatshme, në parking)
- Lidhjet me autopompën (aplikohen në pozicionet më të përshtatshme për lidhjen e automjeteve të zjarfikësive)

b) Pajisjet e lëvizshme të shuarjes së zjarrit

- Bombola portative (shkumë, pluhur, gaz) (aplikohen në përgjithësi në gjithë godinën)
- Bombola karrelato (shkumë,CO₂,) (aplikohen në përgjithësi në ambientin teknik)

Sipas klasifikimit të mësipërm të mjeteve të shuarjes së zjarrit më poshtë po shpjegojmë kërkesat kryesore për fikset portative:

Fikësit portabël të zjarrit:

Në këtë objekt është parashikuar pozicionimi i fikësve portable të zjarrit EN3, pesha 6 kg, klasa 34A 233BC dhe fikës i zjarrit me CO₂ do të jenë të klasës 113B, EN3 në ambiente të veçanta.

Fikëset e zjarrit parashikohen në projekt të vendosen në të gjitha ambientet e shërbimit të katit përdhe si edhe në katin e parë.

Karakteristikat e shuarësve portable 34A 233BC do të jenë si më poshtë:

Type	Cylinder's weight (kg)	Cylinder's material	Extinguish weight (kg)	Extinguish material	Functionality (sec)	Material through (m)	Functioning under the temperatures (°C)	Dimensions Height (mm)	Diam. (mm)	Thickness (mm)
EN3	8,0	Steel	6,0	Powder	20	5	-20/+60	500	150	1.6

Fiksiti me pluhur do të mirëmbahen dhe testohen të paktën në çdo vit nga autoritete të licensuara për këtë qellim. Fikës zjarri me dioksid karboni janë vendosur në të gjitha ambientet me prezence risku nga instalimet elektrike dhe ambientin teknik.

Karakteristikat e shuarësit të zjarrit me CO₂ do të jenë si më poshtë:

Type	Cylinder's weight (kg)	Cylinder's material	Extinguish weight (kg)	Extinguish material	Functionality (sec)	Material through (m)	Functioning under the temperatures (°C)	Dimensions Height (mm)	Diam. (mm)	Thickness (mm)
EN3	14.9	Steel	5,0	CO ₂	17.37	4	-20/+60	751	137	2.0

Fikësit me CO₂ do të mirëmbahen dhe testohen çdo 6 muaj nga autoritete të licensuara për këtë qellim.

Është parashikuar një numër i caktuar me fikësa portativ, pozicionimi i tyre është bërë në pozicione lehtësisht të arritshme në përputhje me kategorinë e zjarrit, të shpërndara në të



gjithë sipërfaqen si dhe është parashikuar shoqërimi i të gjitha pajisjeve shuarëse me sinjalistikat përkatëse treguese, sinjalistikat paralajmëruese si dhe sinjalistikat orientuese të rrugëve të shpëtimit dhe të daljeve të sigurisë, sipas normave me ndriçim normal dhe me ndriçim emergjence.

Një element shumë i rëndësishëm në projektin e mbrojtjes kundra zjarrit është edhe parashikimi i sinjalistikës perkatese të treguara në projekt, nje numer tabelash paralajmëruese, treguese dhe vepruese si:

- Tabela paralajmëruese - jane tabelat që tregojne ndalimin e ndezjes së zjarreve, ndalimit te përdorimit të ujit për shuarje etj.
- Tabela treguese – siç janë drejtimet e daljes nëpër korridore, nëpër shkallë, vendosja e hidranteve dhe të bombolave etj.
- Tabelat vepruese – sinjalizimi nëpërmjet butonit të alarmit, ndërprerja e energjisë elektrike etj.

9. INSTALIMET ELEKTRIKE

Rrjeti elektrik ekzistues në Qendrën Shëndetësore Balldre Lezhë, është i amortizuar, si rrjedhim nuk mund të shfrytëzohet. Rikonstruksioni i këtij rrjeti parashikon demontimin e tij në masën 100 %. Është e nevojshme të ndërtohet rrjet elektrik furnizimi dhe shpërndarjeje të energjisë elektrike sipas kushteve teknike te projektimit dhe standartet e Republikës së Shqipërisë (KTP, STASH, ENSTASH) dhe në Normat dhe rekomandimet e IEC, EN, CENELC. Parashikohet ndërtimi i rrjetit të ndriçimit të emergjencës. Rrjetet e ndriçimit, të prizave, të bojlerëve dhe të kondicionerëve janë të ndarë nga njeri tjetri. Energjia elektrike ndërpritet tërësisht nga kuadri elektrik në hyrje të objektit. Çmimet në preventiv janë vendosur sipas manualit të vitit 2015.

Përcjellsat dhe kabllot

Të gjithë përcjellsat dhe kabllot duhet të kenë çertifikatën e aprovimit të autoriteteve lokale përkatëse dhe çertifikatën e fabrikës. Përcjellsat duhet të jenë bakri të izoluar (veshur) me shtresë teke PVC për tu futur brenda tubave ose kanalave. Të gjitha rastet kur kabllot përfundojnë në një panel shpërndarës ose paisje elektrike etj, duhet lënë një sasi kablli reserve (10-15cm) për të lejuar në të ardhmen zhveshjen e rilidhjen me terminalet pa shkaktuar tërheqje të tyre. Zhveshja e izolimit në kabllot e izoluar me gomë ose PVC duhet të kryhet duke përdorur vegël të përshtatshme për zhveshjen, dhe jo thikë.

Percjellsat duhet të jenë me shtresën izoluese të ngjyrosur për identifikim. Blu-ja duhet të përdoret për përçuesit e neutrit, Jeshilja/e verdha duhet të përdoren për përçuesit e tokës dhe ngjyra e kuqe/jeshil/kafe ose e verdhë për përçuesit fazë. Të bëhet kujdes që ngjyrat e përcaktuara për fazat të mbeten të njëjtat për instalimin në të gjithë shtrirjen e tij.



Të gjithë kabllot duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të kenë vulën e prodhuesit ose prova të tjera të origjinës dhe kontraktuesi duhet të marrë certifikatat e testeve të përhershme të prodhuesit kundrejt një urdhri të dhënë, n.q.s kërkohet nga inxhinieri.

Në një tub zakonisht futet një kabell i vetëm (ose një grup me 3 përcjellës), por nëse duam të rrisim numrin e tyre në kalimet vertikale, numri i kabllave që duhen instaluar në tuba duhet të jetë aq sa të lejojë futjen e lehtë pa dëme të kabllave dhe nuk duhet të zërë në asnjë rrethanë më shumë se 40% të hapësirës. Instalimi duhet të përputhet me KTZ.

Të gjitha kabllot duhet të kenë certifikatën e aprovimit të autoriteteve lokale përkatëse dhe certifikatën e fabrikës prodhuese.

Izolimi i kabllave duhet të durojë 600/1000 V tip-FG7(O)R.

Kabllot fleksibël duhet ti kenë dejet të ngjyrosura për identifikim. Blu-ja duhet të përdoret për përçuesit e neutrit, Jeshilja/e verdha duhet të përdoren për përçuesit e tokës dhe ngjyra e kuqe/jeshil dhe e verdhë për përçuesit fazë. Të njëjtat ngjyra duhet të përdoren për lidhjet në të njëjtën fazë furnizimi për të gjithë instalimet.

Asnjë kabëll me seksion më të vogël se 1.5 mm² për ndriçim dhe 2.5mm² për prizë s' duhet të përdoret me instalim vetëm nëse përmendet në veçanti. Përçuesit e tokës duhet të kenë një masë minimale të kërkuar nga rregullorja.

-Nuk duhet të mbajne me teper se 80% të ngarkesës së tyre nominale korigjuar në përputhje me kushtet e vendosjes

-Rendia e tensionit nga fillimi i rrjetit të T.U. deri tek konsumatori me i largët nuk duhet të kalojë 4%, si për ndriçimin edhe për fuqinë motorrike.

Tipet e kabllave e përcjellesave që do të përdoren janë:

-Kabell fleksibel multipolar, izolim gome etilenpropilenik, riveshur me PVC, tip FG7(O)R 0.6/1kV me përcjelles bakri të ripjekur, që nuk përhapin flakë dhe që nuk përmbajnë halogjene në tymin e djegjes, rrezja e kthesës 4-6 here diametrin, storcimi në terheqje jo më teper se 5kg/mm².

-Përcjellesfleksibel një polar, prej bakri të ripjekur, izolim me rezinë N07V-K, që nuk përhapin flakë, rrezja e kthesës 4 here diametrin, storcimi në terheqje jo më teper se 5kg/mm².

Kabllot e vendosur në kanalinat duhen fiksuar, në veçanti në kalimet vertikale dhe të pjerreta fiksimit duhet të jenë me të dendura dhe të përshtatshme për të mbajtur peshën e tyre. Kabllot vendosen në distancë midis tyre për të siguruar ftohjen e nevojshme.

Për vendosjet brenda tubacioneve, duhet të kemi një montim dhe çmontim komod të kabllave. Ndalohet shtesa e kabllave e përcjellesave brenda tubacioneve. Ata duhet të priten në gjatësinë e duhur për çdo rast.

Kanalet dhe aksesoret

Kabllot dhe përcjellësit e instalimeve elektrike mund të bëhen në dy mënyra:

- Nën suva të futura në tuba PVC fleksibël
- Mbi suva në kanaleta prej lllamarine zinkato të përforcuar

Aksesorët e instalimeve nën suva janë:

- Tubat fleksibël PVC të dimensioneve të ndryshme në varësi të dimensionit dhe të numrit të përcjellesave që do të futen në të.
- Kutitë shpërndarëse
- Kutitë për fiksimin e prizave ose të çelësave

Të gjitha këto vendosen para se të bëhet suvatimi.

Për kryerjen e instalimeve elektrike të futura nën suva duhet të ndiqet rradha e punës si më poshtë:



- Hapja e kanaleve në mur më dimension të tillë që të vendoset lirshëm tubi fleksibël dhe me thellësi të tillë që të mos dalë mbi nivelin e suvasë përfundimtare.
- Vendosen tubat fleksibël dhe kutitë prej PVC të cilët provizorisht fiksohen me allçi (më vonë mbyllen kanalet me llaç suvatimi)
- Pasi është kryer suvatimi, futen telat ose kabllot, me anë të udhëzuesit të tyre, të cilat duhet të hyjnë lirshëm dhe të lihet në të dy krahët një sasi e mjaftueshme për kryerjen e lidhjeve dhe montimeve.

Tubot rigjid duhet te jene te tipit termoplastik,vetshuarës,me çlirim shumë te ulet te halogjeneve,me :

- rezistence 150kg/dm ne 20°C
- rezistenca ndaj nxehtesise nga 20 ne +90°C
- Rigjediteti dielektrikmbi 2000V ne 50Hz per 15'
- vetshuarja ne me pak se 30"
- padjegshmeria 850°C
- reaksioni ndaj zjarrit categoria I,sipas CSE
- ngjyra gri



Tubat fleksibël duhet të jenë sipas standarteve përkatëse të mëposhtme:

- Përputhja me standartet: CEI 23-32.
- Materiali PVC.
- Rezistenca e izolimit: 100 MΩ
- Shkalla IP:IP40
- Qëndrueshmëria ndaj goditjeve:IK08
- Temperatura e instaluar: -5/60 °C

Kanalet dhe vendosja e tubave fleksibël PVC duhet të bëhet në distancë 0.4 m më poshtë nga niveli i tavanit, në vijë të drejtë horizontale dhe zbritjet për çelësa ose prizat të bëhen vertikale të drejta dhe jo me kënd ose në formë harku.



Tub fleksibel per instalime ne beton dhe nen suva



Per instalimet ne ambiente te jashtme brenda ne masiv dheu ose betoni per linja kryesore furnizimi ose ndricim rrugor ose lulishte, trotuare duhet te perdoret tub PVC fleksibël, me dopio veshje, seksioni i te cilit duhet te mundesoje me lehtësi kalimin e linjave kabllore . Seksioni minimal i tubit të perdorur per kete qellim duhet D=60mm.



Tub fleksibël me dopio veshje për instalime në ambiente të jashtme

Kutitë shpërndarëse

Kutitë shpërndarëse në varësi të sistemit që do të përdoret janë për nën suvatim ose mbi suvatim kështu që mënyra e fiksimit të tyre është ose me allçi ose me anë të vidave me upa. Përmasat dhe format e kutive shpërndarëse variojnë sipas rastit dhe nevojës. E rëndësishme është që lidhja e percjellsave/kabllave brenda në kutitë shpërndarëse të realizohet me anë të klemave bashkuese ose fundore.

Sistemi i kanalave

Sistemi i kanalave ashtu si sistemi i tubacioneve nën suva me tuba fleksibël duhet të plotësojë të gjitha kushtet teknike të instalimeve elektrike të përshkruara më sipër .

Sistemi i kanalave përbëhet nga aksesorët e tij si:

- Kanalet me dimensione të ndryshme, në varësi të numrit të kabllave, që do të instalohen në të, gjatësia 2 m
- Këndorët (shërbejnë për formimin e këndeve në instalime) të cilat janë në varësi të kanalit që po shtrihet
- Devijuesit në formë T
- Kutitë shpërndarëse të dimensioneve të ndryshme



Kanalina metalike per magjistralet e linjave elektrike

Ndriçuesit

Ndriçuesit që do të përdoren në këtë projekt duhet të jenë prodhime të çertifikuara europiane, me llampë LED. Për ambientet e dhomave të mjekëve e korridorët , parashikohet ndriçues LED me përmasë 60*60cm, dhe fuqi 33-36W (funksion i prodhuesit), ndërsa për tualetet dhe për ndriçimin e jashtëm tek fasada e hyrjes parashikohet ndriçues LED 26W IP 65. Pozicioni i ndriçuesve duhet të jetë si ai i treguar në projektin elektrik.

Instalimi i ndriçimit do kryhet duke përdorur kabllot FG7(O)R ose percjelles N07V-K, që kalojnë Brenda tubit fleksibël PVC, në përgjithësi të fshehura brenda suvasë së ndërtesës ose në kanaleta kur përdoret sistemi i kanalave.

Kabllot duhet të jenë në seksion minimal 1.5 mm², për ndriçim dhe 2.5 mm², për prizat. Në të gjitha rastet duhet instaluar nje percjelles tokezimi i i ndare nga nuli i punes.

